

Statusi i femrës në Hebraizëm,
Krishtërim dhe Injorancë
Statusi i saj në Islam

GRUAJA E DEVOTSHME

Osman Nuri TOPBASH



Shkodër, 2016

Titulli origjinal: *Yahudilik'te, Hristiyanlık'ta ve Câhiliyye'de
Kadın Bakış Tarzı Nasıl?
Islam Medeniyetinde ise Nasıl?*
SÂLİHA HANIM

Përktheu: Ilir Hoxha; Fatmir Sulaj
Redaktor: Zija Vukaj
Redaktor: Alban Kali
Design: Bledar Xama




PROGRESI sh.p.k. _____

Adresa: Sheshi "2 Prilli" / Rr: Studenti / Shkodër / Shqipëri
Mob: +355 67 60 78484
http: www.progresibotime.com e-mail: botime@progresibotime.com

Adresa Kosovë: Rr: Ardian Zurnaxhiu / pn. Ralin / Prizren
Tel: +381 29 222 795
Fax: +381 29 222 797 e-mail: kosova@progresibotime.com

Adresa Maqedoni: Rr: Stiv Naumov / nr. 9 / lokal 25 / Shkup
Tel: +398 71 956 271 e-mail: maqedoni@progresibotime.com



Statusi i femrës në Hebraizëm,
Krishtërim dhe Injorancë
Statusi i saj në Islam

GRUAJA E DEVOTSHME

Osman Nuri TOPBASHI



PARAQITJE

Falënderimet dhe lavdet i takojnë Allahut të Madhëruar.

Ai që e ka krijuar njerëzimin mashkull-femër, si krijesat më të nderuara.

Përsëndetjet dhe salavatet janë për Profetin e madh.

Ai që e gjallëroi dhe e ndërtoi njerëzimin mashkull-femër, në mënyrën më të bukur brenda krijimit më të mirë.

Lexues të çmuar!

Herë-herë, tmerri i injorancës shfaqet mu në mes të njerëzimit. Nga një anë padrejtësitë më të mëdha që përjetohen në botë e nga ana tjetër gjendja e keqe e grave, e të pafajshmëve dhe foshnjave të mjera.



Mirëpo, në ditët tona:

Faktorët e vërtetë të fatkeqësive e mbulojnë veten dhe të gjithë fajin ia hedhin palës tjetër. Në mënyrë të veçantë, fushatat e shpifjeve dhe përbaltjeve që bëhen kundër Islamit, nuk janë asgjë tjetër përveçse shpifje dhe përbaltje të qëllimshme. Sidomos në lidhje me gratë. Ç'të themi:

*"Nuk habitem nëse përbaltja është bërë modë,
sepse i poshtri që i ka duart në baltë, gjë tjetër
s'mund të hedhë!"*

(Sejri)

Megjithatë:

Pastrimi dhe fshirja e asaj balte, padyshim se është një domosdoshmëri. Ja pra, edhe ky libërth që keni në duar, është një domosdoshmëri e tillë. Ky libër është përgatitur nga i nderuari **Osman Nuri TOPBASH**. Është i vogël, por i mbushur përplot me të vërteta të rëndësishme dhe mësimdhënëse. Në këtë vepër është trajtuar çështja e gruas në fetë e tjera, në kohën e injorancës dhe në botëkuptimin Islam, ku është bërë një krahasim i hollësishëm në bazë të burimeve përkatëse.

Sipas Teuratit dhe Ungjillit të shtrembëruar dhe mentalitetit të injorancës, femra është shumë e pavlerë. Ajo është një korridor i së keqes, një armik, një shejtan dhe një krijesë e mallkuar. Ajo është një makth që poshtërohet, shkelet me përbuzje, digjet, mbytet dhe varroset e gjallë. Mbi të gjitha, në librat e shenjtë (Teurati dhe Ungjilli), ajo tregohet si një fajtoare me anë të vargjeve të tyre të shtrembëruara.

Ky është edhe shkaku që shoqëritë e ndikuara nga besimi dhe kultura e krishterë, hebraike dhe e injorancës, ekzistojnë shpifje, poshtërime, vrasje dhe fatkeqësi në lidhje me femrën. Lumturia, kërkohet në vendin e



mjerimit. Nga një anë kanë çrregullimet dhe çekuilibrimet e veta, nga ana tjetër fajësojnë Islamin me shprehje të çmendura, duke u munduar të fshehin gabimet e veta. Për këtë arsye, ata ende nuk kanë arritur t'i vendosin siç duhet të drejtat e grave në botë me zgjidhjet e padobishme që mundohen të zbatojnë. Madje, as që kanë për t'ia arritur, sepse punët që bëhen në emër të zgjidhjes në sistemet e prishura të besimit, shfaqin rezultate edhe më të këqija.

Në lidhje me këtë çështje, mund të themi se Islami, që është edhe e vetmja fe e vërtetë, bën përjashtim. Ai i fali femrës një vlerë madhështore. Ai i erdhi në ndihmë vajzës së shkëputur me zor prej zemrës së nënës, për t'u varrosur e gjallë. Ai e shpëtoi femrën prej shkeljes me këmbë dhe shpalli se: *“Xheneti është nën këmbët e nënës”*. Islami e ngriti nënën në një nivel të tillë, që të meritojë falënderim për gjatë gjithë jetës. Ai e shpëtoi shoqërinë prej copëzave të thyera të xhamit dhe e ngriti të drejtën e nënës mbi atë të babait. Pasi e shqiptoi tri herë të drejtën e nënës, në fund Rasulullahu (a.s.), shqiptoi të drejtën e babait.

Në çdo periudhë dhe në çdo popull ku përjetohet kjo edukatë dhe parim i mrekullueshëm i Islamit në lidhje me femrën, aty ekzistojnë virtytet e një qytetërimi të pashoq, sepse veçoritë e tyre të larta e kanë ngritur edhe shoqërinë. Vakëfet dhe institucionet që kanë themeluar gratë, janë pemët me rrënjët më të thella në vendet ku ka mbizotëruar administrimi Osman. Këto janë virtyte të larta, degët e të cilave janë mëshira, butësia, dashuria, nderi, morali dhe mëmësia më e mrekullueshme.

Për fat të keq:

Në kohën tonë, ata që nuk edukohen me këtë madhështi të civilizimit të vet, por nën ndikimin e kulturave të huaja, janë larg prej këtij qytetërimi dhe



këtyre virtyteve madhështore. Për shkak se marrin për bazë kulturat e huaja dhe jo Islamin, për fat të keq, sot të gjitha punët dhe veset e këqija të kulturave të huaja gjenden edhe në vendet myslimane. Kush e ka fajin? Islami apo kultura e huaj?

A është faji i Islamit, që i bëri nënat monument mëshire, apo i kulturave të huaja që i bëri ato të kryejnë krime me kasapët e aborteve?

A është faji i Islamit që i bëri gratë një djep dashurie që ndërton fole, apo i kulturave të huaja që e shkatërroi atë duke e hedhur në humnerën e amoralitetit?

A është faji i Islamit, që i ktheu gratë në thesare në sajë të parimeve të privatësisë, apo i kulturave të huaja që i shfaqti të gjitha vlerat e saj si një mall i rëndomtë vitrine dhe e bëri të humbte nderin dhe ndjeshmërinë, duke e zhveshur?

Ja pra, të gjitha këto pyetje gjenden në formën më të përmbledhur dhe më reale në këtë libërth të vogël që keni në duar.

Allahu na bëftë prej atyre që kemi dobi prej këtij libri! Po ashtu, Allahu i bëftë vajzat tona gra të mira si drita e syrit dhe nëna të vërteta! Allahu i bëftë ato nëna të xhenetit që rrisin dhe edukojnë brez pas brezi djem trima, nëna të mira dhe personalitete të virtytshëm e të lartë!

Amin!..

Shtëpia botuese “Progresi”





Statusi i femrës
në Hebraizëm, Krishterim
dhe Injorancë
Statusi i saj në Islam

GRUAJA E DEVOTSHME



“Më i miri në mesin tuaj është ai që sillet më mirë ndaj familjes së tij. Ndërsa ai që sillet më mirë me familjen e tij në mesin tuaj jam unë.”

(Ibn Maxhe, Nikah, 50)



“Ju këshilloj të silleni mirë me gratë!”
(Buhari, Nikah, 80)

Si konsiderohet femra në hebraizëm,
krishterizëm dhe injorancë?
Si konsiderohet në Islam?

GRUAJA E DEVOTSHME

Njëshmëria dhe të qenit i Vetëm, i takon vetëm Allahut.

Nisur nga kjo, Allahu i Madhëruar ka krijuar gjithçka në çift. Tek njerëzit, bimët dhe kafshët kjo shfaqet në formën mashkull-femër. Ndërsa në krijesat jo të gjalla, shfaqet si plus (+) dhe minus (-). Lidhur me këtë, në Kuranin Fisnik flitet në ajete të ndryshme:

“Dhe nga çdo gjë, Ne kemi krijuar dy palë, në mënyrë që ju të vini veshin!” (Dharijat, 49)

“Qoftë lavdëruar Ai që i ka krijuar çift të gjitha llojet: çka mbin prej tokës, ata vetë dhe ato që nuk i dinë!” (Jasin, 36)



Të gjitha krijesat kanë nevojë për njëra-tjetrën nga aspekti i kësaj veçorie të të qenit çift, sepse një cilësi që ndodhet tek njëra, nuk ndodhet tek tjetra. Të gjitha formojnë një të vetme duke plotësuar njëra-tjetrën. Po ashtu, edhe për njeriun vlen e njëjta urtësi e të qenit mashkull-femër. Në një hadith fisnik, urdhërohet:

“Gratë janë gjysma tjetër e burrave.” (Ebu Daud, Taha-ret, 94; Tirmidhi, Taharet, 82.)

Mirëpo, këto dy gjysma të së vërtetës njerëzore zotërojnë cilësi të veçanta, njësoj si polet plus dhe minus. Allahu i Madhëruar dëshiron që besimi, punët e mira, morali i bukur, pra devotshmëria, të jetë tek të gjithë meshkujt dhe femrat. Mirëpo, në lidhje me të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë, të dyja gjinive u janë dhënë pika të veçanta për secilin prej tyre. Ashtu siç i ka bërë të ndryshëm në krijim, Allahu i ka bërë të ndryshëm edhe në të drejta dhe përgjegjësi.

Në përgjithësi:

Për shkak se meshkujt janë të fuqishëm, ndërsa femrat janë delikate, gjatë gjithë historisë, në shoqëritë ku ka mbizotëruar padrejtësia dhe injoranca, femra është shtypur.

Në kohën tonë, për të tërhequr vëmendjen ndaj padrejtësive që u bëhen grave, bota ka vendosur një ditë të veçantë:

Pozita e gruas së mirë dhe e nënës, është shumë e lartë në fenë tonë. Profeti (a.s.), ka thënë: “Nga kjo botë më janë bërë të dashura gruaja (e mirë) dhe aroma e këndshme.

Ndërsa namazi është drita e syve të mi.”

(Nesai, Ishretu'n-Nisa, 10)





8 Marsi Dita botërore e grave...

A është rastësi që një ditë e tillë është vendosur në perëndim?

Jo!..

E shkuara dhe e sotmja e Evropës, në përgjithësi e gjithë perëndimit, është e mbushur me probleme dhe fatkeqësi në lidhje me çështjen e gruas. Tek ata ekziston një botëkuptim i tillë ndaj gruas, që dje buronte prej besëtytnive, ndërsa sot prej dëshirave të epshit dhe mungesës së mëshirës, duke u sjellë midis fanatizmit dhe liberalizmit të tepruar pa e gjetur kurrë rrugën e mesme...

Më parë le të shohim të djeshmen:

GRUAJA NË SYTË E ITHTARËVE TË LIBRIT TË SH TREMBËRUAR. LODRA E SHEJTANIT

Burimi i perëndimit, është Besëlidhja e Vjetër dhe Besëlidhja e Re, të cilat janë shtrembëruar. Pra, Hebraizmi dhe Krishterimi...

Gjurmët e shtrembërimit tek ata mund t'i vëresh edhe në shikimet e tyre përçmuese.

Ata e përçmojnë aq shumë gruan, saqë sipas Talmudit, një mashkull hebre sapo ngrihet në mëngjes:

“Duhet të falënderojë Zotin, për shkak se Ai e bëri pjesëtar të Bijve të Izraelit, nuk e krijoi si grua dhe nuk e

*“O njerëz! Respektojini të drejtat e grave!
Silluni me butësi dhe dashuri ndaj tyre!
Ju këshilloj të kini frikë Allahun në lidhje me to.”*

(Muslim, Haxh, 147)





bëri prej injorantëve/idhujtarëve...” (Menahot, 43b.; A. Cohen, Le Talmud, përkth. Jacques Marty, Paris 1991, fq. 211.) (Talmudi është shpjeguesi i Teuratit)

Përse të jesh grua, tregohet si një fatkeqësi sikur të jesh idhujtar?

Sepse në librin e shtrembëruar, të gjitha të këqijat i atribuohen femrës. Ajo, shihet dhe tregohet si, “hileqare, mashtruese, dinake, trilluese, burim i së keqes, mendjemadhe, e dhënë pas epshit, amorale, grindëse, e papërgjegjshme dhe e prirë për idhujtari dhe besime të kota”. (shih. Mbretërit I. 21/8, 25; Mbretërit II 9/30-37, 23/7, Numrat 31/15-16...)

Në këto tekste gjenden shprehje të tilla që e poshtërojnë femrën:

“Gruaja budallaqe është zhurmëmadhe, aspak e zgjuar dhe nuk di asgjë.” (Fjalët e urta, 9/13.)

“Dhe gjeta një gjë më të hidhur se vdekja; gruan zemra e së cilës është kurth dhe grackë dhe duart e së cilës janë pranga. Kush i pëlqen Perëndisë i shpëton asaj; por mëkatari do të kapet nga ajo.” (Predikuesit, 7/26.)

E vetmja rrugë që mund të jetë zgjidhje, pra edukimi i gruas, është prerë. Në fakt, gruaja jo vetëm që nuk merr pjesë në shumë adhurime, por vajzave u është ndaluar arsimimi dhe në mënyrë të veçantë marrja e dijeve fetare (për shkak se mund ta shtrembërojnë Teuratin). (shih. Talmud Bavli, shevouth, 42a, Baba Kama, 106b, Jevamot, 88b, Sotah, 20a.)

*“O njerëz! Kijeni frikë Allahun
dhe silluni mirë me gratë, sepse ju i keni marrë
ato amanet nga Allahu dhe duke i premtuar
Allahut ju është lejuar t’i keni për gra.”*

(Muslim, Haxh, 147.)





E njëjta konsideratë për femrën vazhdoi edhe në librin e shtrembëruar të krishterëve:

Femra u konsiderua si një krijesë më e ulët se mashkulli. Pali mendon se femra është një shkallë më poshtë mashkullit dhe shprehet:

“Burri nuk ka nevojë ta mbulojë kokën, sepse është shëmbëlltyra e lavdisë së Hyjit; ndërsa gruaja është nderi i burrit. Sepse nuk është burri prej gruas, por gruaja prej burrit. Dhe burri nuk u krijua për arsye të gruas, por gruaja për arsye të burrit. Prandaj, gruaja duhet ta mbajë mbi kokë shenjëën e “vartësisë”, për shkak të engjëjve.” (I. e Korintasve, 11/7-10; shih. I. e Timoteut, 2/11-12.)

Sipas klerikëve fetarë të krishterë, gruaja është ajo që e çmend burrin, që e thërret atë në mëkat dhe që për këtë është një lodër e pistë e shejtanit, së cilës i duhet qëndruar larg. Ja pra, për shkak se gruaja konsiderohet një krijesë e pistë, klasa a murgjve e ka zgjedhur beqarinë si modelin e jetës më ideale.

Baballarët më të rëndësishëm të kishës, që orientojnë Krishterimin, shprehen:

Tertuliani (v. 220), thotë:

“Grua! Ti gjithmonë duhet të jesh e leckosur dhe në zi. Sytë e tu duhet të jenë plot me lot dhe shikimet e tua duhet të tregojnë pendim, me qëllim që të bësh të harrohet se ti e shkatërrove racën njerëzore. Grua! Ti je dera e ferrit! Edhe nëse raca njerëzore do të shuhej, ata duhet të zgjedhin të mos martohen.”

*“Më i miri prej jush,
është ai që sillet më mirë me familjen e tij!”*
(Ibn Maxhe, Nikah, 50; Darimi, Nikah, 55.)





Shën Juan Chrysostome (v. 407) thotë:

“Ndër të gjitha kafshët e egra, nuk mund të gjeni më të dëmshme se gruaja.”

Gjithashtu, Chrysostome, thotë:

“Gruaja, është një e keqe e domosdoshme, një bela e dëshiruar. Ajo është rreziku më i madh i shtëpisë dhe familjes. Ajo është një e dashur e pamoralshme edhe e paedukatë. Një fatkeqësi e zbukuruar dhe mashtruese.”

Ndërsa San Augustine, i përshkruan gratë si të mbushura me të këqija, ziliqare, të pavendosura dhe burimi i të gjitha debateve, grindjeve dhe padrejtësive.

Ajo që fajësohej, ishte e gjithë gjinia femërore, e jo vetëm gratë e prishura e të shturura... Ishte gruaja ajo që e ndoti njerëzimin në mëkat, që prej Havasë/Evës! Kjo shihet qartë edhe në lutjen që thuhet gjatë ceremonive të martesës në kishat katolike, të cilat përsëriten edhe sot e kësaj dite:

“Me mëkat kam rënë në barkun e nënës, mëkat ka bërë edhe nëna ime kur ka mbetur shtatzënë.”

Nëse konsiderata për gruan, martesën dhe familjen është kështu, në Krishterim, “familja” është konceptuar si një institucion krimi, ndërsa “martesa” si një e metë. Madje, mosmartesa e meshkujve dhe e femrave dhe mbyllja e tyre në manastire duke u bërë murgj dhe murgesha, është diçka e lavdëruar në Krishterim. Edhe pse martesa është e pranuar, divorci është i ndaluar tek ata, qoftë edhe për raste të domosdoshme. Në këtë mënyrë,

Hadithi fisnik që tregon për virtytin e edukimit të vajzave:

“Kush kujdeset, i rrit, i edukon më së miri dhe i marton tri vajza apo tri motra, duke e vazhduar edhe më tej mirësinë e tij ndaj tyre, ai person është prej banorëve të xhenetit.”

(Ebu Daud, Edeb, 120-121/5147; Tirmidhi, Birr, 13/1912.)





ata u kanë hapur derën të gjitha botëkuptimeve në kundërshtim me krijimin, si amoralitetit, homoseksualizmit, prostitucionit etj.

Kjo nuk mbaron me kaq:

Në botën e krishterë të mesjetës, gruaja dhe martesë u përbuzën aq shumë, sa që në Koncilin e tretë të Maconit më 585, u diskutua se a kishte shpirt apo jo gruaja.

Lidhur me këtë, në atë periudhë, gjendja e jetës sociale së gruas u përkeqësua edhe më shumë. Prej shekullit XII, në Evropë filloi gjuetia e magjistarëve dhe e shtrigave, ku me pretendimin se kanë lidhje me xhindët/demonët, shumë gra u dogjën në turrën e druve ose u mbytën në ujë.

Ndërkohë që Krishterimi e përçmonte kaq shumë femrën, në kundërshtim me veten, ai e paraqiste Merjemen/Marian si nënë të Zotit, ndërsa melekët, i pikturonin në formën e gruas. Nisur nga kjo, mund të themi se, Krishterimi është i ndërthurur me shumë paradokse.

KONSIDERATA E GRUAS NË INJORANCËN MODERNE: OBJEKT ABUZIMI

Evropa, në periudhën e re që filloi me Renesancën dhe Reformën, këtë herë fanatizmit dhe besëtytnive iu përgjigj me një ekstremizëm tjetër.

Duke u zhytur në kauzën e barazisë me meshkujt, gruaja u shty në rrugë, në fabrika dhe në vitrina. Ato u kthyen në modele që nxisin epshin. Dje nuk vlerësoheshin aspak dhe konsideroheshin si shejtan dhe mëkatare,

*Një hadith tjetër në lidhje me edukimin e vajzave:
"Kush i rrit dhe i edukon dy vajza deri në moshën e pjekurisë,
unë do të jem pranë tij në Ditën e Kiametit."*

(Muslim, Birr, 149.)





ndërsa tani, konsiderohen si krah pune, si pasuri apo si objekt tregtie.

Për shkak të ligjit hyjnor të “tërheqjes”, që gjendet në natyrën e mashkullit dhe femrës, ata e shfrytëzuan prirjen që ka mashkulli ndaj femrës. Shfaqja e bukurisë dhe vlerësimi duke përdorur huret e saj femërore, e paraqitën femrave si liri dhe e drejtë personale. Ndërkohë që mirësia më e madhe e femrës është mëmësia dhe të qenit zonja e shtëpisë së vet, gruaja u fut në një rivalitet me burrat në jetën sociale dhe me kalimin e kohës u largua nga familja. Madje, ajo u bë armike e mëmësisë.

Sepse:

Disa gra që janë rritur dhe edukuar si individualiste dhe egoiste, e konsideruan lindjen e fëmijëve si diçka që është në kundërshtim me dëshirat e tyre, duke e quajtur edhe si shkak i prishjes së bukurisë së trupit të tyre. Në këtë mënyrë, filloi të përhapej edhe më shumë krimi i abortit.

Një kontradiktë e çuditshme është edhe fakti se, megjithëse shumica e tyre e konsumojnë mishin më tepër se gjithë të tjerët, kur vjen Bajrami i Kurbanit, i cili bëhet shkak që të hyjë pak mish edhe në shtëpitë e nevojtarëve, ata fillojnë dhe llomotitin gjoja për të drejtat e kafshëve. Mirëpo, nga ana tjetër, nuk nxjerrin asnjë zë dhe nuk u përpëlit asnjë ndjenjë ndaj krimit të vrasjes së fëmijës në barkun e nënës.

Në botën e këtyre individëve, të cilëve u është shkretuar ndërgjegjja, në vend të fëmijës, ashtu si në kohën e

*“Silluni në mënyrë të barabartë
me fëmijët tuaj në mirësi. Nëse do të mbaja dikë
më lart se të tjerët, do të kisha mbajtur vajzat.”*

(Hejthemi, IV, 153; Ibn-i Haxher,
el-Metalibu'l-Alije, IV, 69.)





inJORANCËS, u përhap mbajtja e kafshëve dhe në veçanti e qenve.

Sipas një transmetimi që vjen prej Katades (r.a.), shkak u që fiset Arabe në periudhën e inJORANCËS i vrisnin vajzat, duke i varrosura të gjalla, ishte se:

“Nëse i linin gjallë vajzat dhe ato rriteshin, mund të kapeshin rob dhe t’u shkelej nderi dhe për shkak të varfërisë.”

Prandaj, për të mos rënë në këtë gjendje, ata i vrisnin vajzat që kur ishin të vogla dhe në vend të tyre mbanin qen. (Taberi, Tefsir, VIII, 68; shih. En’am, 140.)

Të tregosh mëshirë për krijesat dhe t’i ushqesh ato, padyshim që është një virtyt i mirë. Mirëpo, t’i mbash qentë në vend të fëmijëve, duke mos rritur dhe edukuar fëmijë por qen, është një çështje shumë shqetësues në aspektin familjar dhe shoqëror.

Po ashtu, në inJORANCËN moderne u kërkua që gratë ta shihnin statusin e shtëpiakes si një barrë. Dhe si alternativë, u injektuan idetë për t’u divorcuar, për të mos u martuar dhe për të jetuar vetëm. Në vend të martesës, u la vendi flirtit. Në këtë mënyrë u helmua jeta familjare. Fëmijët e paligjshëm, fëmijët me prindër të divorcuar, fëmijët e braktisur etj., u kthyen në një problem serioz në shoqëri.

Me shkatërrimin e jetës familjare u cenua delikatesa midis mashkullit dhe femrës. Dhe me cenimin e delikatesës dhe dashurisë, në një pjesë të shoqërisë, u shfaq homoseksualizmi. Kjo pështirësi që filloi me po-

Omeri (r.a.), ka thënë:

“Në të vërtetë, ne nuk u jepnim aspak vlerë grave në kohën e inJORANCËS. Por me ardhjen e Islamit, Allahu zbriti ajete në lidhje me gratë dhe atyre iu njohën shumë të drejta.”





pullin e Lutit (a.s.), të cilët u fundosën në fund të dheut për këtë shkak dhe që s'mund të përputhet aspak as me natyrën njerëzore, as me familjen, është përhapur duke iu bërë reklamë tërheqëse dhe duke zënë vend në shoqëri.

Kur gruaja në perëndim u mashtrua, u nxor në punë edhe jashtë familjes dhe vazhdoi të shtypej, u shfaq feminizmi dhe kauza e të drejtave të grave. Dhe, për t'i mashtruar në një mënyrë tjetër, gjoja për t'i ngushëlluar ato, 8 Marsi u caktua si Dita Botërore e Grave në kujtim të grave që vdiqën në zjarrin e një fabrike. Tashmë, kjo datë konsiderohet si dita kur kujtohen të drejtat e grave në të gjithë botën.

Mirëpo, ato që thuhet, që fliten, ankesat dhe ato që jepen si zgjidhje, nuk mund të ofrojnë asnjë shërim për shpirtin dhe asnjë zgjidhje për hallet... sepse ato zgjidhje janë larg natyrës njerëzore... sepse janë larg qëllimit të krijimit të gruas.

Ja pra, kjo është "dëftesa" e hidhur e perëndimit në lidhje me gratë në të shkuarën dhe të sotmen. Notat në atë dëftesë, janë shumë të këqija. Mirëpo, po këta që kanë një dëftesë kaq të zezë, fillojnë dhe kritikojnë botëkuptimin e Islamit në lidhje me femrën.

Po Islami?

Çfarë thotë Islami për çështjen e femrës?

GRUAJA E MIRË NË VËSHTRIMIN E ISLAMIT: KRIJESA MË E MIRË NË BOTË

Islami e refuzoi dhe e çliroi gruan nga roli i mjeruar

Çdo gjë e krijuam në çift, që të mendoni e të merrni mësim."

(Dharijat, 49)

"Gratë, janë gjysma tjetër e burrave."

(Ebu Daud, Taharet, 94; Tirmidhi, Taharet, 82.)





dhe i përçmuar që i kishte caktuar injoranca e hershme dhe moderne dhe librat e shtrembëruar.

Fakti që në Kuranin Fisnik ekziston një kapitull/sure i titulluar “en-Nisa/Gruaja” dhe garantimi i të drejtave të grave, si nikahu (celebrim martesë), mehri (dhurata e martesës), trashëgimia, divorci dhe nafaka (ndihma financiare), të cilat përligjen në atë sure dhe në sure të tjera të Kuranit, mjafton për të treguar qëndrimin e Islamit në këtë çështje...

Ndërsa në ajetet që i kanë dhënë edhe emrin sures “Muxhadele”, shprehet ankesa e një gruaje ndaj burrit të saj, të cilën Allahu e ka dëgjuar dhe i ka zbritur zgjidhje.

Omeri (r.a.), shprehet:

“Në të vërtetë, ne nuk u jepnim aspak vlerë grave në kohën e injorancës. Por me ardhjen e Islamit, Allahu zbriti ajete në lidhje me gratë dhe atyre iu njohën shumë të drejta.”

Para ardhjes së Islamit, femra ishte një krijesë e padëshirueshme ende që pa lindur. Në ajetet e Kuranit, gjendja e atyre njerëzve mizorë dhe injorantë të periudhës së injorancës, shprehet me këto fjalë:

“Dhe, kur ndonjëri prej tyre merr lajmin se i lindi një vajzë, fytyra i nxihet dhe i mbushet me mjerim. Ai fshihet nga njerëzit për shkak të lajmit të keq që mori dhe s’di: a ta mbajë këtë fëmijë, pavarësisht poshtërimit apo ta varrosë në dhé. Ah! Sa mbrapsht që gjykojnë ata!” (Nahl, 58-59)

*Mashkulli dhe femra, janë të barabartë para Allahut në aspektin e devotshmërisë.
Femra nuk konsiderohet kurrë e metë dhe e mangët tek Allahu për shkak të të qenit femër.*





Në shekullin tonë, vetëm në Kinë janë vrarë në barkun e nënës me abort, gjashtëdhjetë milion vajza me vendimin e prindërve të tyre, vetëm sepse ishin vajza. Ndërsa në Indi, po me të njëjtën mënyrë janë vrarë 12 milion vajza.

Mirëpo, sipas lëvizjes feministe, aborti është e drejta e gruas!

Ja pra këto janë dy qëndrimet mjerane në kauzën e të drejtave të grave...

Ndërsa pozita që u dha Islami fëmijëve vajza, u ngrit në këtë nivel:

“Kush kujdeset, i rrit, i edukon më së miri dhe i marton tri vajza apo tri motra, duke e vazhduar edhe më tej mirësinë e tij ndaj tyre, ai person është prej banorëve të xhenetit.” (Ebu Daud, Edeb, 120-121/5147; Tirmidhi, Birr, 13/1912)

“Kush i rrit dhe i edukon dy vajza deri në moshën e pjekurisë, unë do të jem pranë tij në Ditën e Kiametit.” (Muslim, Birr, 149)

Profeti (a.s.), e refuzoi edhe botëkuptimin e ngritjes së fëmijëve meshkuj mbi fëmijët femra. Një ditë kur Profeti (a.s.), qëndroi në shtëpinë e vajzës së tij Fatmës (r.anha.), dy nipërit e tij, Hasani dhe Husejni kërkuan ujë prej Profetit (a.s.), i cili i dha më parë Hasanit. Për këtë arsye, Fatma, mendoi se Profeti e donte më shumë Hasanin. Mirëpo, Profeti (a.s.), i tha:

“Jo, por Hasani kërkoi ujë i pari.” (shih. Ahmed, I, 101.)

Më pas, tha:

*Për shkak të kumtimit të fesë dhe aftësisë së mashkullit
në planin shoqëror, profetët janë të gjithë meshkuj.
Mirëpo, çdo profet e ka sjellë në jetë një grua e devotshme.
Vetëm profeti Adem (a.s.), ka ardhur
në jetë pa nënë dhe pa babë.*





“Silluni në mënyrë të barabartë me fëmijët tuaj në mirësi. Nëse unë do të mbaja dikë më lart se të tjerët, do të kisha mbajtur vajzat.” (Hejthemi, IV, 153; Ibn-i Haxher, el-Metalibu'l-Alije, IV, 69.)

Në periudhën e injorancës para Islamit, edhe gruaja e rritur përçmohej shumë. Pjesa e saj në trashëgimi ishte zero. Kur i vdiste burri, ajo i kalohej vëllait të tij, duke u konsideruar si mall. Ndërsa në luftërat ndër-fisnore, shkelja e namusit të saj, shihej si mënyrë hakmarrjeje ndaj armikut. Ajo i nënshtrohej dhunës, përdhunimit dhe shpifjes, ndërsa pasuria dhe mehri i grabiteshin. Prostitucioni kishte arritur kulmin. Gjithashtu, edhe shumë metoda të tjera që zbatoheshin nën emrin e nikahut, ishin të mbushura plot padrejtësi dhe amoralitete.

Më pas erdhi Islami, i cili i doli kundër çdo dhune e padrejtësie dhe i dha gruas të drejtat dhe vlerën që i takonte. Islami është feja e natyrshmërisë. Për rrjedhojë, ai është edhe ligji hyjnor i caktuar nga Krijuesi i Madhëruar për krijesat e Tij, të cilat i njeh më mirë se kushdo.

Nisur nga kjo:

◆ **Mashkulli dhe femra, janë të barabartë para Allahut në aspektin e devotshmërisë. Femra, nuk konsiderohet kurrë e metë dhe e mangët tek Allahu për shkak të të qenit femër.**

Në Islam, ku faji nuk i atribuohet dikujt tjetër, nuk ekziston as koncepti i “mëkatit fillestar”. Çdo njeri vjen në jetë me një faqe të pastër e të bardhë.

Martesa i jep shpirt prirjes epshore të njeriut me anë

*“Kur një burrë qëndron vetëm për vetëm
me një grua të huaj, i treti i tyre është shejtani.”*

(Tirmidhi, Rada, 16/1171.)





të marrëveshjes në emër të Allahut. Në follenë familjare që formohet me këtë shpirt, edukohen individë të dobishëm për shoqërinë.

Për shkak të kumtimit të fesë dhe aftësisë së mashkullit në planin shoqëror, profetët janë të gjithë meshkuj. Mirëpo, çdo profet e ka sjellë në jetë një grua e devotshme. Vetëm profeti Adem (a.s.), ka ardhur në jetë pa nënë dhe pa babë.

Merjemja e nderuar, është një grua shembullore, e cila përmendet 34 herë në Kuran dhe lavdërohet për nderin, përkushtimin ndaj adhurimeve dhe ndaj rrugës së Allahut. Po ashtu, edhe gruaja e faraonit, Asia, është një nga gratë e bekuara që lavdërohen në Kuran për besimin dhe mbështetjen e fortë tek Allahu. Në disa ajete ku numërohen robërit me të cilët është i kënaqur Allahu, janë përmendur në mënyrë të veçantë edhe gratë:

“Me të vërtetë që për myslimanët dhe myslimanet, besimtarët dhe besimtare, të bindurit ndaj Allahut dhe të bindurat ndaj Allahut, të drejtët (të sinqertët) dhe të drejtat (të sinqertat), durimtarët dhe durimtare, të përlurur dhe të përlurur, mirëbërësit dhe mirëbërëset, agjëruesit dhe agjërueset, ruajtësit e nderit dhe ruajtëset e nderit, përkujtuesit e Allahut vazhdimisht dhe përkujtueset, pra, për të gjithë këta Allahu ka përgatitur falje dhe shpërblim të madh.” (Ahzab, 35)

Personi i parë që i besoi Profetit (a.s.) dhe e mbështeti fort atë, është nëna jonë Hadixhe (r.a.). Në një hadith lidhur me të, thuhet: *“Një të tretën e fesë suaj mësojeni prej saj!”* (Dejlemi, II, 165/2828) Gjithashtu, një prej shtatë saha-

Një familje ku nuk është harruar Islami, ku gruaja burrit dhe burri gruas i kujton ahiretin dhe që të dy janë bashkuar me dashamirësi dhe dashuri, aq sa ta ngrenë njëri-tjetri në namazin e natës duke e spërkatur me ujë, ajo është foleja më e luntur në botë. Kjo familje ka dy veçori: Dashurinë dhe Devotshmërinë.





bëve muxhtehidë, Ibn Abbasi (r.a.), shprehet se prej dijes së nënës sonë Aishe (r.a.), ka përfituar çdo muxhtehid. Të gjitha këto tregojnë qartë se në Islam, gratë nuk i janë nënshtruar asnjë ndarjeje negative.

♦ Për shkak se cilësitë e natyrës së mashkullit dhe të femrës nuk janë krijuar të njëjta, po ashtu edhe shpërndarja e detyrave të tyre, të drejtat dhe përgjegjësitë nuk janë të njëjta.

Gruaja është krijuar delikate dhe e ndjeshme. Në aspektin trupor, ajo nuk ka fuqi fizike aq sa burri. Përkundrajs, ajo është e pajisur me ndjenja mëshire, dashurie dhe butësie më të forta se të burrit. Ndërkohë që babai nuk duron shumë, nëna rri zgjuar deri në mëngjes për shkak të një fëmije që qan. Nëse fëmija bie në lumë, babai edhe mund të ngurrojë, por nëna shkon direkt pas tij për ta shpëtuar.

Cilësitë e natyrës së femrës, janë në përputhje me detyrat e saj si zonjë shtëpie dhe nënë. Ajo do të marrë përsipër detyrat e shtëpisë, do të lindë dhe do të rrisë fëmijë, duke i ushqyer ata me dua dhe devotshmëri dhe duke i edukuar me moral të bukur. Ashtu si është krijuar burri në aspektin fizik dhe shpirtëror për t'iu përshtatur detyrave jashtë shtëpisë, ashtu edhe gruaja ka një natyrë të përshtatshme për botën e brendshme.

Për këto arsye, pozita e gruas së devotshme dhe nënës në fenë Islame, është shumë e lartë. Profeti (a.s.), ka thënë:

“Nga kjo botë më janë bërë të dashura gruaja (e mirë)

Në arkivat Osmane gjenden të shënuara 1400 vakëfe të ndërtuara nga gratë. Sot, ne nuk i shohim zbukurimet dhe xhevahiret e atyre nënave të bekuara, sepse ato ia kushtuan botës tjetër sendet e tyre me vlerë.





dhe aroma e këndshme. Ndërsa namazi është drita e syve të mi." (Nesai, Ishretu'n-Nisa, 10)

Për shkak se gruaja zotëron ndjenja dhe delikatesë në bazë të përgjegjësi të mëdha që ka, ajo nuk duhet të detyrohet të luftojë me kushtet e vështira të botës jashtë. Prandaj femra në fëmijëri i është lënë amanet babait, në qoftë se nuk e ka, gjyshit, pastaj xhaxhait, vëllait, e më pas burrit, djemve dhe nipërve të vet. Mirëpo, kjo lënie si amanet, nuk do të thotë se është lënë në mëshirë të tyre. Porositë e mëposhtme e shprehin qartë se gratë i janë lënë amanet dashurisë, respektit, moralit dhe aftësisë së botës së burrave:

"...Jetoni e silluni mirë me to!.." (Nisa, 19)

"Xheneti gjendet nën këmbët e nënave." (Nesai, Xhihad, 6)

"Më i miri prej jush, është ai që sillet më mirë me familjen e tij." (Ibn Maxhe, Nikah, 50; Darimi, Nikah, 55)

"Mos i rrihi gratë!.. Kush i rreh gratë, nuk është njeri i mirë." (Ebu Daud, Nikah, 42; Ibn-i Maxhe, Nikah, 51)

"O njerëz! Respektojini të drejtat e grave! Silluni me butësi dhe dashuri ndaj tyre! Ju këshilloj të kini frikë Allahun në lidhje me to, sepse ju i keni marrë ato amanet nga Allahu dhe duke i premtuar Allahut ju është lejuar t'i keni për gra." (Muslim, Haxh, 147.)

Gratë që edukohen me devotshmëri, edukojnë fëmijë të mirë. Nëna është një shkollë më vete. Prandaj, një nënë e devotshme e meriton të falënderohet gjatë gjithë jetës.

Një sahab shkoi tek Profeti (a.s.) dhe e pyeti:

Në bazë të harmonisë hyjnore që Allahu i Madhëruar ka vendosur ndërmjet krijesave, gratë dhe burrat kanë nevojë për njëri-tjetrin. Burri dhe gruaja, janë dy dimensione që plotësojnë njëri-tjetrin. Vazhdimësia e racës njerëzore, e për rrjedhojë e jetës, ka nevojë për bashkimin e burrit me gruan, pra për institucionin e familjes të zbkuruar me devotshmëri.





“Kush është njeriu me të cilin duhet të sillem më mirë?” Profeti (a.s.), i përgjigjet:

“*Nëna jote!*” Sahabi pyeti përsëri:

“Po pas saj?” Profeti (a.s.):

“*Nëna jote!*” Sahabi përsëriti të njëjtën pyetje:

“Po pas saj kush vjen?” Profeti (a.s.), përsëri i dha të njëjtën përgjigje:

“*Nëna jote!*” Sahabi vazhdoi të pyesë:

“Po pas saj?” Këtë herë, Profeti (a.s.), tha:

“*Babai yt!*” (Buhari, Edeb, 2)

Islami nuk i ka ngarkuar gruas përgjegjësi materiale, si sigurimin e jetesës për familjen etj. Por i ka dhënë asaj të drejtë për trashëgimi dhe zotërim pasurie. Ashtu siç mund të bëjë punë në përputhje me detyrat dhe ndjenjat e saj, ajo është e lirë edhe në menaxhimin e pasurisë që zotëron.

Vendet ku mund të punojë një grua myslimane, nuk duhet të jenë të përziera me burra dhe ku mund të qëndrojnë vetëm për vetëm me ta.

Nëna jonë Hadixhe (r.a.), kishte një pasuri të sajën që e kishte fituar me tregti dhe ishte e para që e shpenzoi atë për myslimanët.

Po ashtu, edhe bashkëshortet e nderuara të Profetit tonë (a.s.), nënat tona, Seude dhe Zejnebja (r.a.), fitonin para prej përpunimit të lëkurëve dhe me to bënë barmirësi.

*Allahu i Madhëruar i ka krijuar meshkujt
dhe femrat që të jenë burim qetësie dhe prehje për njëri-tjetrin.
Pikërisht nga kjo varet edhe vazhdimësia dhe lumturia shoqërore.
Dhe për këtë, të dyja palët duhet t'u dalin zot
detyrave dhe përgjegjësi të veta.*





Në periudhën e Perandorisë Osmane, gratë zotëronin qindra vakëfe, të cilat kanë vepruar në një fushë shumë të gjerë. Këta shembuj tregojnë qartë se sa ndikuese mund të jetë gruaja në jetën sociale, pa u shkatërruar nëpër rrugë.

Gratë e famshme të asaj periudhe, si zonja Zubejde, Gevher Nesibe, Sulltaneshë Mihrimah, Nënata e sulltanëve Gylnush Emetullah, Pertevnijal, Bezm-i Alem etj., janë vetëm disa prej grave që kanë lënë në kulturën dhe qytetërimin islam gjurmë të mëdha nëpërmjet bamirësive të tyre.

Në arkivat Osmane gjenden të shënuara 1400 vakëfe të ndërtuara nga gratë. Sot ne nuk i shohim zbukurimet dhe xhevahiret e atyre nënave të bekuara, sepse ato ia kushtuan botës tjetër sendet e tyre me vlerë. Me anë të xhamive, medreseve, çezmave, hamameve, komplekseve, mensave dhe bibliotekave që themeluan, ato zbukuruan botën e tyre të zemrës dhe botën e përtejme.

Ata që pandehin se gruaja myslimane është person i burgosur në shtëpi dhe nuk ka asnjë ndikim në shoqëri, bëjnë mirë t'i lexojnë këto të dhëna dhe t'i korrigjojnë mendimet e tyre:

Nëna e sulltanit Bezm-i Alem, e cila jetonte në Stamboll, themeloi një vakëf në Siri. Subjekti dhe kushtet e këtij vakëfi, ishin këto dy pika:

- Ujin e pijshëm të Sirisë, t'ua dërgonin hanxhinjve.
- Dëmshpërblimi i sendeve që thyenin apo humbis-

*"Të gjithë jeni barinj dhe të gjithë jeni përgjegjës për tufën tuaj.
Burri është bariu i familjes së tij dhe përgjegjës për të.
Ndërsa gruaja është bashesha e shtëpisë së burrit të vet
dhe po ashtu edhe ajo është përgjegjës për tufën e vet."*

(Buhari, Vesaja, 9; Muslim, Imare, 20)





nin shërbëtorët, me qëllim që ata të mos fyheshin apo dëmtoheshin.

Ky humanizëm dhe horizont solidariteti, nuk është i veçantë vetë për një grua. Nëna e sulltanit Mahpejker Kose, e cila njihej për madhësinë e saj, përkrah shumë xhamive dhe komplekseve, është e famshme edhe për themelimin e vakëfeve për të martuar vajzat jetime dhe të varfra.

Gjithashtu, një pikë e kushteve të vakëfit të sulltaneshës Hatixhe Turhan, tregon një delikatesë të veçantë:

Kjo pikë ka të bëjë me mbushjen e depove të çezmave me sherbet mjalti gjatë netëve të mira dhe të Ramazanit, me qëllim që të qerasesh xhemati pasi dilte nga xhamia. Madje, në kushtet e vendosura për këtë vakëf, ishte caktuar edhe cilësia e mjaltit që do të përdorej. Në kushtet e vakëfit, ishte theksuar se sado i shtrenjtë të jetë mjalti, do të përdoret mjalti më cilësor që gjendej në Pazar.

Ndërsa sulltaneshja Mihrimah, e cila ka ndërtuar dy xhami, një në Edirne Kapë dhe tjetra në Yskyardar, përveçse ishte bamirëse e madhe, ajo ishte edhe shumë modeste dhe e përlurur. Kur dëgjoji se sistemi i ujit që ishte ndërtuar kohë më parë nga gruaja e Harun Rashidit, zonja Zubejde, me qëllim që të furnizonte hanxhinjtë me ujë në Arafat, ajo i doli garant kësaj pune me bizhuteritë dhe xhevahiret e saj personale. Madje, ajo kishte kërkuar që e gjithë kjo bamirësi të ngelej e fshehtë.

Këta shembuj mjaftojnë për të treguar se në Islam, ngarkimi i gruas me çështjet e fëmijëve dhe të familjes,

"Prej argumenteve të Tij është që prej jush krijoi për ju bashkëshortet tuaja, që të qetësoheni pranë tyre, duke vënë ndërmjet jush dashuri dhe mëshirë. Me të vërtetë, në këtë ka shenja, për njerëzit që mendojnë."

(Rum, 21)





nuk përbëjnë pengesë që ajo të marrë pjesë në veprimtaritë e dobishme shoqërore, si themelimi i vakëfeve dhe kryerja e bamirësive.

Mirëpo, Islami nuk e detyron gruan të bëjë punë jashtë shtëpisë pa dëshirën e saj.

Caktimi i të drejtave dhe përgjegjësive të ndryshme për gruan dhe burrin për shkak të dallimeve të tyre në natyrë dhe aftësi, është pjesë e drejtësisë hyjnore.

Ndërsa e kundërta e kësaj, pra detyrimi i gruas në barazimin me burrin, duke mos i marrë për bazë dallimet në natyrën e krijimit, është padrejtësi dhe mungesë mëshire.

Në bazë të studimeve të bëra, del në pah se në perëndim, gruaja shtypet në shkolla dhe në jetën e punës dhe detyrohet të bëjë të njëjtën punë me burrat, por me më pak pagesë.

Por më e rëndësishmja është roli i veçantë i gruas në shoqëri dhe në çështjet familjare. Botëkuptimi që e ka nxitur gruan në botën e jashtme me sloganet e “barazisë”, “rivalitetit”, “karrierës” dhe “lirisë”, e ka dobësuar jashtë mase institucionin familjar. Sot në perëndim, familja është drejt rënies. Gruaja ka mbetur në mes të gërmadhave të familjes së copëtuar, ka humbur pozitën e të qenit nënë dhe i është nënshtuar sulmeve fizike dhe shpirtërore të meshkujve të pamëshirshëm. Për rrjedhojë, ta quash “liri” këtë “braktisje”, është vetëm një paradoks.

Bataku i zhveshjes dhe abuzimit të gruas, nuk mund të thahet nëse gruaja nuk kthehet në pozitën e saj fis-

- *Gra të devotshme*
- *Fëni një të devotshëm*
- *Bashkëshortë të devotshëm që e kryejnë detyrën e kryefamiljarit me devotshmëri...
Rezultati: Një shoqëri e devotshme.]*





nike në çerdhen e saj. Dhe pa u tharë ky batak, është e kotë të luftosh me mizat apo mushkonjat. Për rrjedhojë, masat e marra nga Evropa për të ndaluar dhunën ndaj grave, nuk po japin rezultate pozitive. Ndërsa rezultatet negative të këtij fenomeni, po shkaktojnë edhe më tepër shkatërrimin e institucionit të familjes. Kjo, sepse këto masa rezultojnë me ftohje nga martesat, me ndarje dhe me mbajtjen larg saj.

Masat e vërteta që duhen marrë, janë edukimi moral individual dhe shoqëror i mashkullit dhe femrës. Ashtu siç e eliminoi Profeti ynë (a.s.), dhunën e periudhës së injorancës së vjetër, kështu mund të veprohet edhe sot në kohën injorancës moderne. Pra, me moralin e Kuranit...

Me largimin prej dritës profetike, ne po zhytemi në errësirën e injorancës. Me largimin e moralit të Muhamedit (a.s.), dhuna dhe ashpërsia ka filluar të mbizotërojë në jetën tonë. Kur ne përfaqësonim fytyrën e qeshur të Islamit, edhe gratë tona kishin pozitën e zonjave. Edhe sjellja e burrave ndaj tyre, ishte në mënyrën më të bukur dhe më delikate. Për personat me probleme familjare, kishte teqe ku mund të qetësoheshin. Ndërsa për gratë që dhunoheshin kishte krahë të ngrohtë ku mund të strehoheshin. Lidhjet familjare dhe farefisnore, ishin të forta. Atë që rrëzohej kishte kush e ngrinte, atë që humbiste rrugën, kishte kush e udhëzonte. Urdhërimi për punë të mira dhe pengimi nga punët e këqija, ishte mbizotërues.

Parimi ishte altruizmi, jo egoizmi, ishte mëshira, jo dhuna, ishte durimi, jo nxitimi, ishte duaja, jo rebelimi,

*Gruaja nuk është as gonxhe trëndafil,
e as gjemb. Nëse di ta edukosh, bëhet trëndafil,
nëse e lë pa edukuar, bëhet gjemb."*





ishte ndërtimi, jo shkatërrimi. Martesa ishte e lehtë, ndërsa zinaja pothuajse e pamundur. Atëherë ekzistonte frika prej divorcit pa shkak, sepse për këtë dridhet Arshi i Allahut. Për rrjedhojë, divorci kërkohet vetëm në kushte shumë ekstreme.

Mirëpo, në shekujt e fundit, në të gjithë botën islame u shfaq perëndimorizimi, imitimi i Evropës, largimi nga të vërtetat e fesë ose, edhe nëse në dukje janë të lidhur me fenë, njerëzit nuk ia kanë haberin shpirtit të vërtetë të fesë. Si rezultat i kësaj, u pakësua dashuria e burrave për gratë e tyre dhe respekti i grave për burrat e tyre.

Televizioni, interneti dhe moda hynë në shtëpi dhe e tjetërsuan, e bënë të huaj, umetin e Muhamedit (a.s.), duke e edukuar atë në një kah negativ. Teknologjia e egërsoi dhe ia shkatërroi shpirtin njeriut. Si rezultat i kësaj, ashtu siç ndodh në perëndim, edhe në shoqërinë myslimane u shfaqën sjellje të injorancës, në formën e përbuzjes, urrejtjes dhe dhunës ndaj gruas.

Sot, njerëzit që ushtrojnë dhunë ndaj gruas, nuk janë njerëz të edukuar me moralin islam të Muhamedit (a.s.). Përkundrazi, ata janë njerëz të bombarduar nga programet negative, telenovelat dhe filmat amoralë, të cilat promovojnë zhveshjen dhe përbuzin vlerat e vërteta familjare.

Ndërkohë, disa oportunistë, tentojnë të na zbatojnë shembullin e Evropës në anë të kundërt, duke u përpjekur të na e tregojnë ilaçin si sëmundje dhe duke fajësuar zgjidhjen si problem. Pra, ata po mundohen ta akuzojnë Islamin për mosvlerësim të gruas.

*Nënat janë heroina mëshire për fëmijët e tyre.
Më frikacakja prej tyre, e sakrifikon heroikisht
jetën për fëmijën e vet.*





Mirëpo, ja cilat janë të vërtetat:

E shkuara e tyre, e shihte gruan të pavlerë, madje si të mallkuar. Ndërsa sot, për ta, gruaja është objekt i vitrinave të epshit!..

Ndërsa në Islam, vlera që i jepet gruas së mirë, i ngjan një gote kristali:

TË MOS THYEN QELQURINAT!

Në kohët kur udhëtimet bëheshin mbi deve, njerëzit i nxitnin devetë me ritmin e shkretëtirës. Në një udhëtim të tillë, një shërbyes i quajtur Enxheshe, i nxiste devetë duke kënduar ode. Mirëpo, kjo shpejtësi, mund të mos ishte e përshtatshme për gratë që ndodheshin në kabinën sipër devesë. Për këtë arsye, Profeti (a.s.), tha:

“O Enxheshe! Kujdes mos na thyhen qelqurinat!”

(Buhari, Edeb, 95; Ahmed, III, 117)

Profeti (a.s.), duke synuar gratë, u shpreh sikur ato të ishin enë kristali për të cilat duhet treguar shumë kujdes...

Kjo pra ishte delikatesa dhe kujdesi i Profetit tonë (a.s.)...

Meshkujt mund të jenë të fortë e të hekurt. Por gratë janë si qelqi...

Profeti (a.s.), ishte aq i mëshirshëm dhe i dhembshur, saqë mendonte se nuk ishte e drejtë t'i detyroje gratë të udhëtonin në kushtet e përshtatshme vetëm për meshkujt...

*“Askush të mos e urrejë gruan e tij.
Nëse nuk e pëlqen një cilësi të saj,
mund të pëlqejë një cilësi tjetër.”*

(Muslim, Rada, 61)





Atëherë?

A është barazi të veprosh në mënyrë të njëjtë si me hekurin, ashtu edhe me qelqin?

Në bazë të harmonisë hyjnore që Allahu i Madhëruar ka vendosur ndërmjet krijesave, gratë dhe burrat kanë nevojë për njëri-tjetrin. Burri dhe gruaja janë dy dimensione që plotësojnë njëri-tjetrin. Vazhdimësia e racës njerëzore, e për rrjedhojë e jetës, ka nevojë për bashkimin e burrit me gruan, pra për institucionin e familjes të zbukuruar me devotshmëri.

Çdo çift, që prej shtresës më të ulët, e deri tek shtresa më e lartë, ka nevojë për lumturinë e çerdhes familjare. Allahu i Madhëruar, i ka krijuar meshkujt dhe femrat që të jenë burim qetësie dhe prehje për njëri-tjetrin. Pikërisht nga kjo varet edhe vazhdimësia dhe lumturia shoqërore. Dhe për këtë, të dyja palët duhet t'u dalin zot detyrave dhe përgjegjësive të veta. Për rrjedhojë, të dyja palët duhet t'u dalin zot detyrave dhe përgjegjësive të veta.

Femra nuk mund të bëhet mashkull. Prandaj është kundër natyrës së saj ta detyrosh atë për këtë, sepse cilësitë që i janë dhënë mashkullit janë të ndryshme, ndërsa ato që i janë dhënë femrës janë të ndryshme. Nëse detyrohen që të dy të bëhen njësoj, atëherë prishet harmonia. Profeti ynë (a.s.), ka thënë:

“Të gjithë jeni barinj dhe të gjithë jeni përgjegjës për tufën tuaj. Burri është bariu i familjes së tij dhe përgjegjës për të. Ndërsa gruaja është bashesha e shtëpisë së burrit të

“O i Dërguari i Allahut, cili është ai ndaj të cilit duhet të sillemi më mirë?

“Nëna, pastaj nëna, më pas përsëri nëna dhe më pas babai. Pas këtyre, ai që është më i afërt.”

(Muslim, Birr, 2.)





vet dhe po ashtu edhe ajo është përgjegjës për tufën e vet.”

(Buhari, Vesaja, 9; Muslim, Imare, 20.)

Përgjegjësitë dhe fushat e tyre janë të ndara. Mirëpo, në Evropë e kanë prishur rregullin njerëzor, duke e joshur egon e gruas dhe duke e detyruar atë të dalë përtej fuqisë së vet. Tani, popullsia në Evropë është duke rënë vazhdimisht. Dhe për rrjedhojë, po dobësohet shumë edhe familja.

Atëherë:

A mund të quhet dhënie e të drejtave të gruas nxitja e saj për rivalitet me meshkujt në botën e egër të meshkujve, në të njëjtat kushte, duke i marrë shpirtin asaj? Mos vallë quhet shoqëri që i respekton gratë, ajo që i thyen kristalet dhe i mbush rrugët me copat e thyera? A e quajnë mirësi ndaj gruas kur e privojnë atë nga mëmësia dhe e detyrojnë të punojë duke përdorur aftësitë e saj tërheqëse dhe duke e quajtur të emancipuar? Apo e quajnë privilegj për gruan kur e detyrojnë të endet midis familjes, fëmijës, prindërve dhe universitetit, karrierës e kërkimit të punës?

A mos vallë e quajnë zgjidhje të dhunës brenda familjes, kur i thonë gruas: “Nuk je shërbyesja e burrit dhe fëmijëve të tu. Prandaj shko dhe fitoje jetën tënde si shërbyese e të huajve, e mos ia ki nevojën askujt!”?

A nuk e kuptojnë ata se shtyrja e femrës në lirinë e egos, në fakt është shtyrje e fëmijëve të saj në robërinë e mungesës së nënës dhe në mjerimin e shndërrimit të shpirtit të saj në një mall që bie sa në një dorë në një dorë tjetër?

*Lum ata
që i edukojnë vajzat e tyre
në frymëzimin shpirtëror të Merjemes,
Hadixhes dhe Fatimes (r.a.)...*





Jo!..

Zgjidhja është të sillesh me hekurin si me hekurin dhe me xhamin si me xhamin. Pra, duke i dhënë çdokujt detyrën e përshtatshme me natyrën e krijimit të vet dhe për atë që është më i aftë.

Zgjidhja është ta edukosh mashkullin të jetë i mëshirshëm, i drejtë, i virtytshëm, i kuptueshëm, i ndërgjegjshëm dhe i moralshëm!.. Jo duke e detyruar, por duke i edukuar zemrën, me qëllim që të kërkojë shpërblimin e përjetshëm. Ndërsa femrën, duke e edukuar të jetë e ndershme, e dhembshur, e mëshirshme, e durueshme dhe delikate, si një zonjë e botës së familjes dhe fëmijëve të saj, që janë edhe natyra e krijimit të saj... Pra, në ndërtimin e një shoqërie të devotshme.

Në një ajet fisnik, urdhërohet:

“...O Zoti ynë, dhurona nga gratë tona dhe trashëgimtarët tanë, çështë prehje për sytë tanë dhe bëna shembull për të mirët!”. (Furkan, 74)

- Gra të devotshme
- Fëmijë të devotshëm
- Bashkëshortë të devotshëm që e kryejnë detyrën e kryefamiljarit me devotshmëri...

Rezultati: Një shoqëri e devotshme.

Devotshmëri, është frika për të dëmtuar. Është ruajtje. Një shoqëri e tillë është një shoqëri që ruhet nga

“Frikësojuni Allahut në lidhje me njerëzit që keni nën vartësi. Frikësojuni Allahut në lidhje me dy qenie të dobëta: gruan e ve dhe jetimin. Po ashtu frikësojuni Allahut në lidhje me namazin!”

(Bejhaki, Shuab, VII, 477)





dëmtimi i gruas, nga shkelja e të drejtave të saj dhe nga dhuna ndaj saj. Një shoqëri që ruhet prej çdo sjelljeje fyese, përbaltëse dhe cenuese ndaj gruas.

Lum ata që i edukojnë vajzat e tyre në frymëzimin shpirtëror të Merjemes, Hadixhes dhe Fatmës (r.anhuma)...

Lum ata që i edukojnë edhe djemtë e tyre të mos u thonë nënave as “of”, të sillen mirë me bashkëshortet e tyre, t'i ngrenë ato me buzagaz në namazet e natës dhe t'i rrisin vajzat e tyre në mënyrë që të bëhen gra të devotshme!..

Amin!..



Nëna vetëmohuese që ia përkushton të gjithë qenien e vet familjes, meriton një dashuri të pamatë, një respekt të thellë dhe një falënderim të përjetshëm. Lum ato gra dhe nëna që lënë pas zë të mirë nën këtë qiell!





NËNA:
NJË SHKOLLË
MË VETE



"Xheneti është nën këmbët e nënave."

(Nesai, Xhihad, 6; Ahmed, III, 429)



"Zoti im! Fali prindërit e mi!.." (Nuh, 28)

NËNA: NJË SHKOLLË MË VETE

Edukimi fillon në familje. Edukatori i parë i njeriut është nëna.

Në të shkuarën, familja në shoqërinë tonë, ka qenë e fortë. Brenda kësaj familjeje, nënat e ardhshme edukoheshin në formën më të mirë.

Me kalimin e kohës, përbërja e fortë familjare filloi të prishej. Tashmë, lidhja biologjike e prindërve me fëmijët, nuk shpreh pothuajse asgjë. Për këtë arsye, për të edukuar nënat e së ardhmes, duhet një institucion më serioz. Prandaj, sot, kurset e Kuranit duhet t'i përgjigjen kësaj nevoje.

Edukimi dhe përgatitja në atmosferën e Kuranit dhe Sunetit të nënave që do të edukojnë brezat e ardhshëm, i



ka mbetur këtyre institucioneve. Për këtë arsye, në lidhje me mësimin e çështjeve të brendshme dhe të jashtme të fesë, të zbatimit të saj dhe forcimin e devotshmërisë, këto kurse të Kuranit nuk duhen neglizhuar.

Nënat e së ardhmes duhen përgatitur nën atmosferën e Kuranit. Kjo, sepse mëmësia është shumë e rëndësishme. Allahu i Madhëruar, përkrah vlerës së madhe që i ka dhënë nënës, i ka ngarkuar asaj edhe detyra shumë të rëndësishme. Përgjegjësja e parë për edukimin e brezave, është nëna. Profeti (a.s.), në lidhje me nënat që janë pajisur me aftësitë e duhura për ta kryer ashtu siç duhet këtë detyrë, thotë:

“Xheneti është nën këmbët e nënave.” (Nesai, Xhihad, 6; Ahmed, III, 429)

Këtu bëhet fjalë për një vlerësim të mirë ndaj nënave. Dhe ky vlerësim, bëhet për shkak se nëna ka cilësinë e të qenit edukuesja më e rëndësishme në shoqëri.

Nënat janë ato krijesa, të cilat na mbajnë për një farë kohe në bark, pastaj në krahë dhe deri në fund të jetës na mbajnë në zemër. Prandaj, ato meritojnë dashurinë dhe respektin tonë më të thellë.

Nënat, të cilat e kanë marrë mbi supë menaxhimin e shtëpisë dhe edukimin e fëmijëve, meritojnë një dashuri me të vërtetë të madhe, një respekt të thellë dhe një falënderim të përzjetshëm.

Edhe personaliteti dhe njeriu më i madh, Profeti ynë

*Allahu i Madhëruar kërkon prej nesh
që të ndërtojmë një shoqëri të devotshme.
Prandaj, nënat e ardhshme duhet t'i edukojmë
me një pjekuri të tillë shpirtërore, që të mund
t'i shërbejnë ashtu siç duhet këtij synimi.*





(a.s.), që ishte “Rahmeten li’l-Alemin/mëshirë për botët”, e admironte shumë bashkëshorten e tij Hadixhen (r.a.), e cila i zotëronte këto cilësi. Ajo, me ndershmërinë, sedrën dhe besnikërinë që e karakterizonte, është shembulli më i bukur për një nënë.

Për nëna të tilla, është thënë:

“Një nënë me të vërtetë e devotshme, është mësuesja më e mirë.”

Nëse e shohim nga ky aspekt, nënat shfaqen para nesh, si persona që “orientojnë shoqërinë”. Por, në cilin drejtim duhet të jetë orientimi që do t’i japin nënat shoqërisë?

Ashtu si t’i edukojmë nënat, edhe ato, në bazë të atyre parimeve do ta ndërtojnë shoqërinë në të ardhmen. Allahu i Madhëruar, prej nesh kërkon që të ndërtojmë një shoqëri të devotshme. Prandaj, nënat e ardhshme duhet t’i edukojmë me një pjekuri të tillë shpirtërore, që të mund t’i shërbejnë ashtu siç duhet këtij synimi.

Nënat janë edukuesit e parë të fëmijëve tanë...

Fëmijët tanë, janë amanet i Allahut për ne. Edukimi i tyre në mënyrë të mirë dhe të rregullt, me qëllim që të bëhen individë të dobishëm për shoqërinë, është detyra e të gjithëve. Kjo, mund të realizohet vetëm nëse i mbushim zemrat e tyre me kulturën e Kuranit dhe Sunetit të Profetit (a.s.).

Për këtë, duhet të punojmë...

Edukimi fillon në familje. Edukuesi i parë i njeriut është nëna. Islami nuk e sheh nënën thjesht si një përbërje biologjike. Në përbërjen shpirtërore të nënës, ndodhet cilësia e edukimit. Një fjalë e urtë thotë: “Nëna është një shkollë.”





Pikësëpari, duhet të përpiqemi me të gjitha mundësitë të edukojmë mirë edukuesit e parë, pra, nënat.

Ne duhet të përpiqemi shumë për të ndërtuar një shoqëri të zbukuruar me devotshmëri dhe që është si drita e syrit.

Për rrjedhojë, kjo përpjekje e jona, do të jetë edhe një tregues i afërsisë dhe dashurisë ndaj Profetit (a.s.).

PROFETI (A.S.), NUK E NEGLIZHOI EDUKIMIN E GRAVE SAHABE

Profeti (a.s.), me anë të mësimimit, edukimit, pastrimit shpirtëror dhe bisedave, arriti ta nxjerrë njeriun e periudhës së injorancës, nga errësira në dritë. Ai, gjithmonë është përpjekur të edukojë sahabët në çdo vend, si në xhami, ashtu edhe gjatë udhëtimit apo luftës. Në këtë çështje, ai nuk e neglizhoi as edukimin e grave sahabe, duke filluar prej familjes së tij fisnike dhe të afërmve të tij.

Ashtu si sahabët, të cilët i rrinin gjithmonë afër të Dërguarit të Allahut (a.s.), edhe gratë sahabe janë përpjekur të mësojnë Kuranin dhe hadithet e Profetit (a.s.), duke dëshiruar të përfitonin prej frymëzimit të tij shpirtëror. Me dëshirën e madhe që kishin, ato dolën para të Dërguarit të Allahut (a.s.) dhe iu lutën:

“O i Dërguari i Allahut! Prej fjalëve tuaja përfitojnë gjithmonë burrat. Na e ndani edhe ne grave një ditë, në të cilën të mblidhemi dhe të na mësoni edhe neve ato që ju mëson Allahu juve!”

I Dërguari i Allahut (a.s.), u tha:

*“Kjo botë përbëhet nga dobi të përkohshme.
Qenia më e mirë që i jep dobi asaj,
është gruaja e devotshme.”*

(Muslim, Rada, 64.)





“Mirë, filan ditë do të mblidheni në këtë vend!”, duke iu caktuar atyre një ditë të javës. (Buhari, I’tisam, 9; Muslim, Birr, 152)

Kur Profetit (a.s.), i zbriste ndonjë prej ajeteve të Kuranit, në fillim ua lexonte burrave, pastaj grave. (shih. Ibn Is’hak, fq. 128.)

Gjithashtu, Profeti (a.s.), i kishte dhënë detyrën e mësimin të grave të tjera edhe nënës sonë Aishe dhe bashkëshorteve të tjera (r.anhuma). Madje, *“njërën prej dyerve të xhamisë, ia kishte caktuar vetëm grave”*. (shih. Ebu Daud, Salat 53/571.)

Po ashtu, edhe gratë e ensarëve i kishin kërkuar Profetit tonë (a.s.), të mësonin çështjet në lidhje me gratë dhe turpi nuk i pengoi ato nga mësimi i dijeve. Aishja (r.anaha), ka thënë:

“Sa të mira janë gratë ensare. Turpi nuk i ka penguar ato nga mësimi i çështjeve fetare.” (Muslim, Hajz, 61.)

Ndërkohë që gratë sahabe nga një anë përpiqeshin të mësonin moralin Islam në sajë të ligjëratave dhe fjalimeve të Profetit (a.s.), nga ana tjetër kanë pasur gjithmonë mundësinë për të shkuar tek Profeti (a.s.), me qëllim që të gjenin zgjidhje për problemet me të cilat përballeshin dhe për të marrë përgjigje për pyetjet që u vinin në mendje. Ndërsa Profeti (a.s.), i ka vlerësuar gratë dhe u është përgjigjur nevojave të tyre duke u interesuar për çdo problem të tyre. (shih. Muslim, Fedail, 76; Ebu Daud, Edeb, 12.)

Në një hutbe, Profeti (a.s.), ka thënë:

“O njerëz! Nëse është dikush prej jush që ka frikë prej

*“Një grua merret për bashkëshorte për katër shkaqe:
Për pasurinë e saj, fisin e saj, bukurinë e saj
dhe për fenë e saj. Zgjidhni atë
që është fetare, që të keni begati.”*

(Buhari, Nikah, 15; Muslim, Rada 53)





vetes, të ngrihet në këmbë e të lutem për të!” (Pas disa burrave që kërkuan lutje prej Profetit) Një grua u ngrit në këmbë prej vendit ku qëndronin gratë dhe tha:

“Unë kam këto e këto lloj problemesh. Lutuni Allahut që të më largohen këto probleme!” Ndërsa Profeti ynë (a.s.), i tha:

“Shko në shtëpinë e Aishes!” Më pas, Profeti (a.s.), zbriti prej minberit. Kur u kthye në shtëpinë e Aishes (r.anha), e preku në kokë me bastunin e tij gruan që i kërkoi lutje dhe u lut për të. (shih. Ibn Sad, II, 255.)

Dëshira e grave sahabe për ta ndërtuar jetën e tyre në këtë botë dhe në botën tjetër me Fjalën e Allahut dhe Sunetin e Profetit (a.s.) dhe përpjekjet e tyre për t'i zgjidhur çështjet dhe problemet e tyre në bazë të tyre, është shembull shumë i bukur për ne.

Njëherë, Profeti (a.s.), këshilloi një grua prej fisit Gifar, duke i thënë:

“Merr një enë uji dhe hidh pak kripë në të. Pastaj me të laj gjakun që të prek mbulesën!”

Gruaja sahabe, e cila i bindej me shumë dashuri Profetit tonë (a.s.), e zbatoi këtë këshillë të tij me një kujdes të madh gjatë gjithë jetës së saj, duke mos larë asnjëherë rroba pa i hedhur kripë ujit. Madje, ajo kishte lënë amanet, që kur të ndërrojë jetë, t'i hidhet kripë edhe ujit me të cilin do të lahet xhenazja e saj.” (Ebu Daud, Taharet, 122/313.)

Gratë në ditët tona, duhet të marrin shembull prej grave sahabe dhe nuk duhet ta neglizhojnë asnjëherë mësimin e fesë së tyre.

Kur u zbrit ajeti që njoftonte për gjynahun e atyre që mbledhnin ar dhe argjend dhe nuk dhuronin, sahabët pyetën: “Çfarë të mbledhim?”

J Dërguari i Allahut (a.s.), tha: “Gjërat më të çmuara që mund të zotërohen, janë: gjuha që përmend Allahun, zemra që falënderon dhe gruaja e devotshme që e ndihmon besimin e burrit të saj...”

(Tirmidhi, Tefsir, 9/9.)





Ky është arsimimi i vërtetë që i duhet një gruaje dhe një nëne myslimane, sepse ardhmëria e vërtetë, është ajo e botës tjetër.

VULLNETI I GRAVE SAHABE DËR TË FITUAR SEVAPE.

Ashtu si në marrjen e dijeve, gratë sahabe garonin me sahabët për të fituar sevape dhe për të qenë shpirtërisht afër me Profetin (a.s.).

Esmā (r.anha), e cila ishte vajza e sahabiut Jezid bin Sekene (r.a.), ishte një grua shumë e zgjuar. Një ditë, ajo u dërgua nga gratë tek Rasulullahu (a.s.), të cilit iu drejtua me respekt të thellë dhe me ëmbëlsi të madhe duke i thënë:

“T’u bëfshin kurban nëna dhe babai im o i Dërguar i Allahut! Unë jam dërguar nga gratë si përfaqësuese e tyre. Allahu i Madhëruar, të ka dërguar ty si Profet për të gjithë burrat dhe gratë. Ne gratë të kemi besuar ty dhe Zotin tënd.

Mirëpo, ne kemi mbetur të mbyllura në shtëpi, duke u shërbyer burrave tanë dhe duke rritur fëmijë. Ndërsa ju (burrat), merrni pjesë në faljen e namazit të xhumasë dhe të namazit me xhemat në xhami, vizitoni të sëmurët, falni namazet e xhenazeve, bëni haxh mbi haxh dhe çështë më e rëndësishmja, luftoni në rrugë të Allahut, etj., duke qenë më lartë se ne (në sevape).

Mirëpo, kur ju dilni nga shtëpia për të shkuar në haxh dhe umre dhe për të luftuar me jobesimtarët, ne

*Një grua e devotshme e ndihmon burrin e saj
në besimin dhe në zbukurimin e jetës
me vepra të mira. Një grua e tillë, është mirësia
më e madhe për një burrë.*





ruajmë pasurinë tuaj, endim veshjet tuaja dhe rrisim fëmijët tuaj. Atëherë, a jemi edhe ne ortakë në shpërblimin që merrni ju prej punëve të mira që bëni o Rasulullah?”

Pasi i dëgjoi me vëmendje fjalët e Esmasë (r.anha), Rasulullahu (a.s.), u kthye nga sahabët që ndodheshin aty pranë dhe tha:

“A keni dëgjuar fjalë më të bukura prej këtyre nga një grua që pyet në lidhje me çështjet e fesë?” Sahabët thanë:

“O i Dërguari i Allahut! Neve nuk na e merrte mendja se një grua mund të shprehej kaq bukur!”

Rasulullahu (a.s.), duke iu drejtuar Esmasë (r.a.), tha:

“O grua! Dëgjo dhe tregojua edhe grave që të kanë dërguar, se nëse gruaja shkon mirë me burrin e saj dhe fiton kënaqësinë e tij, ajo do të fitojë të njëjtat sevape.”

Kur u kthye për të ikur, nga gëzimi i madh që kishte, gruaja thoshte shehadetin dhe madhëronte Allahun. (Shih. Ibn-i Asakir, Tarihu Dimashk, VII, 363-364, XXIX, 65-67; Bejhaki, Shuab, VI, 421; Hejthem, IV, 305; Ibnu'l-Esir, Usdu'l-Gabe, VII, 19)

Ky hadith fisnik, tregon se çfarë dëshire të madhe kanë pasur gratë sahabe për të shtuar pasurinë e tyre të botës tjetër. Ndërsa përgjigjja që i dha i Dërguari i Allahut (a.s.), vërteton se fusha e veprimtarisë së gruas myslimane, është shtëpia e saj.

Një grua tjetër sahabe, Ummu Ri'l (r.anha), ishte një grua që fliste bukur, kishte zemër të pastër, recitonte

Lutja e Profetit (a.s.), për familjen plot dashuri dhe devotshmëri: “Allahu e mëshiroftë atë që cohët natën për të falur namaz, duke e ngritur edhe gruan/burrin. Dhe, nëse nuk ngrihet e spërkat me ujë në fytyrë!”

(Ebu Daud, Tatauu, 18, Vitr, 13.)





ëmbël, ishte e zgjuar dhe e urtë. Një ditë, ajo doli para Rasulullahut (a.s.), dhe i dha selam. Pasi tregoi respektin e duhur ndaj tij, i foli me edukatë dhe pas perdes, duke i treguar se për shkak se ndodhej në urdhrat e burrit, ajo ishte shumë e zënë me ushqimin e fëmijëve dhe punët e tjera të shtëpisë. Ummu Ri'l (r.anha), vazhdon:

“Për ne është e pamundur të marrim pjesë në luftë dhe të fitojmë shpërblime të mëdha. Prandaj, na mëso diçka që t’i afrohem më shumë Allahut me të!”

Ajo foli shkurt, por bëri një kërkesë shumë kuptimplotë, e cila përmbante shumë mirësi. Për këtë arsye, Profeti (a.s.), i tha:

“Përmendeni Allahun ditën dhe natën. Ruajini sytë nga shikimi i të huajve dhe zërin tuaj nga dëgjimi i tyre!” Me këto fjalë, Profeti (a.s.), e këshilloi me diçka që do t’u sillte shpërblimin e xhihadit dhe do t’i afronte me Allahun e Madhëruar. (Ibn Haxhe, el-Isabe, VIII, 204.)

Megjithatë, pati edhe prej atyre grave që morën pjesë personalisht në luftë. Një prej tyre, është edhe Ummu Umare (r.anha), e cila mori pjesë në luftën e Uhudit duke luftuar me armikun me shigjetat dhe harkun e saj. Kur Rasulullahu (a.s.), u kthye prej luftës në Medinë, tha:

“Gjatë luftës, sa herë që kthehesha majtas-djathtas, shihja Ummu Umaren që luftonte përkrah meje.” (Ibn Haxher, el-Isabe, IV, 479)

Ummu Umare (r.anha.), e cila për këtë arsye gëzoi

Muhamed Ikbal:

*“Fatimja, është një shembull për ty.
Mos ia ndaj sytë dhe zemrën asaj, derisa
edhe dega jote të japë një frut Husejn; trëndafilishtat
të sjellë stinën e vjetër.”*





lëvdata dhe lutje të ndryshme prej Profetit (a.s.), i tha Rasulullahut:

“Lutu Allahut, që në xhenet të jemi fqinjët e tu.” Pas kësaj, Profeti (a.s.), u lut duke thënë:

“O Allah! Bëji këta fqinjët dhe shokët e mi në xhenet!”

Kur dëgjoi këtë lutje, Ummu Umare (r.a.), tha:

“Tashmë çfarëdo fatkeqësie të më vijë në këtë botë, nuk e kam hall fare!” (Uakidi, I, 273; Ibn Saïd, VIII, 415)

Sa e mrekullueshme është dëshira e kësaj sahabeje për të qenë mbrojtësja e Profetit (a.s.), në këtë botë dhe fqinja e tij në botën tjetër!

Një tablo tjetër e bukur prej Uhudit, është edhe kjo:

Ditën e Uhudit, Medina u trondit nga një lajm:

Kur u dëgjua fjala: “Muhamedi (a.s.), u vra!”, në qytet filluan të bërtiturat dhe vaji u çua në kupë të qiellit. Të gjithë dolën në rrugë dhe përpiqeshin të merrnin ndonjë lajm prej atyre që vinin. Zonjës Sumejra, që ishte prej ensarëve, i kishte ardhur lajmi se dy djemtë e saj, babai, burri dhe vëllai i saj kishin rënë dëshmorë. Mirëpo, ajo grua e bekuar, nuk u shqetësua shumë për këtë. Ajo që e shqetësonte me të vërtetë atë, ishte gjendja e Profetit tonë (a.s.). Për këtë arsye, ajo rrinte duke pyetur:

“A i ka ndodhur gjë atij?” Sahabët me të cilët takohej gjatë rrugës, i thanë:

Muhamed Jkbal:

“O grua e devotshme! Ti je uji i jetës së filizit të shoqërisë.

Ti je roja që mbron amanetin e umetit. Zbuloji me mendjen tënde virtytet e larta të natyrës tënde!”





“Falënderimi i takon Allahut. Rasulullahu është mirë. Ai është gjallë, ashtu siç dëshiron ti!”

Mirëpo, zonja Sumejra (r.anha), tha përsëri:

“Zemra ime nuk do të qetësohet pa e parë atë. Ma tregoni të Dërguarin e Allahut.”

Kur iu tregua, ajo menjëherë shkoi, e kapi për cepin e rrobës dhe i tha:

“T’u bëfshin kurban nëna dhe babai im o Rasulullah! Nëse je ti gjallë, nuk më shqetëson asgjë tjetër!” (Uakidi, I, 292; Hejthemi, VI, 115)

Ja pra, ky është kulmi i dashurisë që ndjehej për Profetin (a.s.) dhe këto janë shembujt e sakrificës dhe virtyteve që shfaqën zemrat besimtare që ishin mbushur me atë dashuri...

Fjalët që u tha njerëzve sahabiu Abdullah bin Eufa (r.a.), ku i vdiq gruaja, janë shembulli më i bukur i entuziazmit të shërbimit që treguan sahabët fisnikë në rrugën e Allahut të Madhëruar:

“Barteni xhenazen e saj, sepse ajo dhe shërbyeset e saj bartnin gurë natën për ndërtimin e xhamisë së Profetit (a.s.), e cila u ndërtua mbi devotshmërinë. Ndërsa ne burrat, i bartnim ditën dy nga dy.” (Hejthemi, II, 10)

Gratë sahabe, të cilat nuk dinin të ndaleshin në garën

*Heronjtë e padukshëm të luftës së Çanakalasë,
janë nënat që i dërguan bijtë e tyre në frontin
e luftës për mbrojtjen e atdheut, duke thënë:
“Ata janë kurbanë në rrugën e Allahut!”.*





e fitimit të sevapeve, një ditë, dërguan përsëri tek Profeti (a.s.), një grua të quajtur Selame.

Kjo grua ishte dadoja e Ibrahimit, njërit prej bijve të Profetit (a.s.). Ajo ka transmetuar hadithe edhe prej Enes bin Malikut (r.a.). Selame (r.anha), doli para Rasulullahut (a.s.) dhe i tha:

“O i Dërguar i Allahut! Ju i përgëzoni me shumë mirësi burrat, ndërsa ne grave nuk na përgëzoni!” Profeti (a.s.), tha:

“A ta kanë mësuar gratë këtë?” Selame (r.anha), tha:

“Po, ato ma kanë mësuar këtë!” Pas kësaj, Profeti ynë (a.s.), tha:

“A nuk do të kënaqej ndonjëra prej jush sikur të lindte fëmijë ndërkohë që burri i saj është i kënaqur me të dhe t’i jepet shpërblim në rrugë të Allahut (si ata që falin namaz, që agjërojnë dhe luftojnë)? Ndërsa kur të sjellë në jetë fëmijën e saj, mirësitë që ka përgatitur Allahu për të, nuk i dinë as banorët e tokës dhe as të qiellit.

Për çdo pikë qumështi që pi foshnja e saj, nënës i jepet një e mirë. Dhe nëse fëmija e saj e lë pa gjumë natën, asaj i shkruhet sevap, sikur ka liruar shtatëdhjetë robër për hir të Allahut.” (Hejthemi, Mexhmau’z-zeuaid, IV, 304-305)

Këtë përgëzim të Profetit tonë (a.s.), e meritojnë edhe nënat në ditët tona. Mjafton që të zotërojnë cilësitë e grave të devotshme...

Kur një sahab përgatitej të dilte nga shtëpia, gruaja e këshillonte: “Ki frikë Allahun dhe mos fito në rrugë haram! Ne mund ta durojmë urinë në këtë botë, por nuk mund ta durojmë dënimin e xhehenemit në botën tjetër!”





CILËSITË E GRUAS SË DEVOTSHME

I Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

“Kjo botë përbëhet nga dobi të përkohshme. Qenia më e mirë që i jep dobi asaj, është gruaja e devotshme.” (Muslim, Rada, 64; shih. Nesai, Nikah, 15; Ibn-i Maxhe, Nikah, 5.)

Një mirësi kaq e dobishme, pra gruaja e devotshme, ka katër cilësi:

1. MBËSHTETJA NË DUNË TË MIRA

Një grua e devotshme e mbështet burrin e saj në punë të mira.

Në përgjithësi, pas burrave të suksesshëm qëndron një grua e devotshme. Për shembull, njeriu i parë që e mbështeti Profetin (a.s.), në fillim të misionit të tij, ishte nëna jonë Hadixhe (r.a.), të cilën Profeti (a.s.), nuk e harroi gjatë gjithë jetës.

Gjatë një bisede familjare, Profeti (a.s.), foli gjatë për Hadixhen (r.a.), duke i risjellë disa kujtime dhe duke kujtuar kohët e shkuara. Ndërsa nëna jonë Aishe (r.a.), e habitur nga kjo, tha:

“O Rasulullah! Çfarë dobie ka ta kujtosh kaq shumë një grua të moshuar që ka ndërruar jetë vite më parë? Allahu ju ka falur më të re dhe më të bukur se ajo. Pra, ju ka dhënë më të re se ajo grua e moshuar që nuk i kishin ngelur dhëmbë në gojë.” (Buhari, Menakibu'l-Ensar, 20.)

Si përgjigje ndaj këtyre fjalëve të nënës sonë Aishe

Muhamed Ikbal:

“O grua islame, që të janë lënë amanet mirësitë e fesë!

*Prushi i zjarrit të fesë së vërtetë,
është ndezur prej teje.”*





(r.a.), prej gojës së bekuar të Profetit tonë (a.s.), rrodhën këto fjalë kuptimplote që tregonin se përse ai nuk mund ta harronte Hadixhen (r.a.):

“O Aishe! Shkaku që nuk e kam harruar Hadixhen edhe pas kaq vitesh, nuk është prej bukurisë së saj të jashtme. Kur të gjithë më refuzuan dhe më mohuan, Hadixhja më besoi dhe më aprovoi.

Kur idhujtarët përreth meje më thanë: “Je gënjeshtar!”, Hadixhja më tha: “Po thua të vërtetën, mos u tërhiq kurrë!”

Kur njerëzit nuk më dhanë qoftë edhe një kacidhe, Hadixhja e vuri të gjithë pasurinë e saj para meje dhe më tha: “Këto janë të gjitha nën urdhrat e tua. Mund të shpenzosh sa të duash.”

Ditët kur mbeta i vetëm në këtë botë, Hadixhja nuk më braktisi kurrë dhe thoshte: “Të gjitha këto janë të përkohshme. Së shpejti, këto vështirësi do t'i lënë vendin lehtësive.”

Ja pra, për këto sakrifica të saj, unë nuk mund ta harrojë Hadixhen!”

Po ashtu, edhe në sukseset e Aliut (r.a.), duket qartë roli i bashkëshortes së tij, Fatmës (r.a.).

Devotshmëria e nënës, është shumë e rëndësishme në ndërtimin e një familje të devotshme. Lidhur me këtë, Profeti ynë (a.s.), ka thënë:

“Një grua merret për bashkëshorte për katër shkaqe: Për pasurinë e saj, fisin e saj, bukurinë e saj dhe për fenë e

Mbulesa...

*Është edhe shkak i mbrojtjes së nderit të gruas,
por edhe një tablo e delikatesës dhe madhështisë
së gruas myslimane... Ajo është mbrojtje
e personalitetit femëror.*





saj. *Zgjidhni atë që është fetare, që të keni begati.*” (Buhari, Nikah, 15; Muslim, Rada 53)

Një grua e devotshme, e ndihmon burrin e saj në besimin dhe në zbukurimin e jetës me vepra të mira. Një grua e tillë, është mirësia më e madhe për një burrë.

Zejneb binti Xhahsh (r.anha), ishte një grua që merrej me punë dore dhe ishte shumë e aftë në këtë punë. Kur i shiste punët e dorës që kishte përfunduar, fitimin e saj e shpenzonte për hir të Allahut. Profeti (a.s.), iu drejtua njerëzve të familjes dhe u tha:

“Ai që do të më arrijë më shpejtë dhe më herët prej jush, është ai që e ka krahun më të gjatë.”

Aishja (r.a.), thotë:

“Nga malli për Profetin, ne matnim krahët tanë për të kuptuar se kush do ta arrijë atë më shpejt. Mirëpo, në kuptimin që e kishte përdorur Profeti, krahëgjata ishte Zejnebja, sepse ajo bënte punë dore dhe fitimin e falte.” (Muslim, Fedaulu’s-Sahabe, 101.)

Theubani (r.a.), transmeton:

“Kur u zbrit ajeti; **“...Ata që grumbullojnë ar dhe argjend dhe nuk e shpenzojnë për hir të Allahut, paralajmëroji me dënim të dhembshëm.”** (Teube, 34), ne gjendeshim në një udhëtim së bashku me Profetin (a.s.). Disa nga sahabët, thanë:

«Ajo që do të zbriste në lidhje me arin dhe argjendin, zbriti! (Tashmë nuk do t’i mbledhim më ato. Ato që janë

Mbulesa... Do të thotë të mos bëhesh mjet i nxitjes së epsheve të egos dhe të jesh shprehje e vlerës që u jep të tjerëve ndjenjën e delikatesës dhe edukatës... Ajo është sekreti i ruajtjes së bukurisë vetëm për ata që e kanë hallall dhe mos shfaqja e saj të huajve...





jashtë nevojës tonë do t'i falim.) Ah sikur ta dinim se çfarë është më mirë të mbledhim dhe të fitojmë pak prej saj.»

Pas këtyre fjalëve, Rasulullahu (a.s.), tha:

«Më e mira e atyre që zotërohen, janë: Një gjuhë që përmend Allahun. (Duke mos e harruar në asnjë fazë të jetës.); Një zemër falënderuese. (Për çdo mirësi që ka dhuruar Allahu.); Një grua e devotshme, e cila e ndihmon besimin e burrit të saj.» (Tirmidhi, Tefsir, 9/9)

Një familje ku nuk është harruar Islami, ku gruaja burrit dhe burri gruas i kujton ahiretin dhe që të dy janë bashkuar me dashamirësi dhe dashuri, aq sa ta ngrenë njëri-tjetri në namazin e natës duke e spërkatur me ujë, ajo është foleja më e lumtur në botë. Kjo familje ka dy veçori: Dashurinë dhe Devotshmërinë.

Profeti (a.s.), ka një dua shumë të bukur për burrin dhe gruan e një familjeje të tillë: *“Allahu e mëshiroftë burrin që çohet natën për të falur namaz, duke e ngritur edhe gruan e tij. Dhe, nëse ajo nuk ngrihet e spërkat atë me ujë në fytyrë. Po ashtu, Allahu e mëshiroftë edhe atë grua që çohet natën për të falur namaz, duke e ngritur edhe burrin e saj. Dhe, nëse ai nuk ngrihet e spërkat atë me ujë në fytyrë!”* (Ebu Daud, Tatauu, 18, Vitri, 13)

Nënat e devotshme, janë ato që i japin fëmijëve të një populli entuziazmin e besimit, dashurinë për popullin dhe atdheun dhe dëshirën për çdolloj sakrifice për hir të tyre. Heronjtë e padukshëm të luftës së Çanakalasë, janë nënat që i dërguan bijtë e tyre në frontin e luftës për mbrojtjen e atdheut, duke thënë: *“Ata janë kurbanë në rrugën e Allahut!”*

Midis mashkullit dhe femrës ekziston një prirje e natyrshe dhe e pandryshueshme ndaj njëri-tjetrit, e cila shërben për vazhdimin e njerëzimit. Nëse nuk respektohet siç duhet urdhri hyjnor i mbulesës, kjo prirje, mund të kthehet në një shkatërrim moral të rrezikshëm, e cila mund të çojë deri aty, sa të shkelen edhe kufijtë hyjnorë.





Në letrën që nëna e Hasanit prej Jozgatit, të cilin ajo e dërgoi në Luftën e Çanakalasë duke ia lyer flokët me këna, shkruhej:

“Biri im! Ti je kurban i zgjedhur i kësaj familjeje. Në fshatin tonë, delet që ndahen për kurban shënohen me këna. Kështu edhe unë, ndër të gjithë fëmijët, ty të kam zgjedhur si kurban për vatanin. Për këtë arsye, t’i kam lyer flokët me këna. Melekët që tani do të përmendin me mëshirë.”

Në një nga ditët me shi dhe të freskët të vjeshtës së vitit 1915, një nënë e moshuar me flokë të thinjur, bel të kërrusur dhe fytyrë të zbehtë prej fshatit Akgunlu, po përcillte djalin e saj për në front në stacionin e Bilexhikut. Ndërkohë që e shtrëngonte djalin e saj, ajo i thoshte:

“Husejni im, biri im trim!.. Edhe daja yt ka rënë dëshmor në Shëpka, babai yt në Domeke, ndërsa vëllezërit e tu më të mëdhenj ranë dëshmorë në Çanakala. Ti je pjesa ime e fundit. Nëse zëri i ezanit në minare do të ndalet dhe kandilat e xhamisë do të shuhen, haram të qoftë qumështi im. Vdis dhe mos u kthe në fshat!

Nëse të bie rruga nga Shëpka, mos harro të këndosh një Fatiha për shpirtin e dajës! Ec biri im! Allahu ta priftë mbarë!..”

Gruaja e devotshme, e shqetësuar për botën tjetër dhe e cila e ndërton jetën e saj mbi themelet e devotshmërisë, qëndron larg haramit dhe kërkon vetëm hallallin.

2. KËRKON VETËM HALLALLIN

Abdullah bin Mes’udi, na tregon për gruan sahabe,

*Një nga kuptimet e urdhrit hyjnor të Allahut të Madhëruar,
“Mos iu afroni zinasë!..” (Isra, 32), është edhe, “Mos ia hapni rrugën,
mos i jepni mundësi zinasë, duke mos respektuar urdhrin
e mbulesës.” Ai që ecën në buzë të greminës,
gjithmonë ka mundësi të bjerë në të.*





bota shpirtërore e së cilës ishte shkrirë në Kuran dhe Sunet dhe bënte kujdes shumë të madh për kafshatën hallall:

“Kur një sahab vinte në shtëpi, gruaja e tij i bënte menjëherë këto dy pyetje:

1. Sa ajete të Kuranit kanë zbritur sot?

2. Sa prej haditheve të Profetit (a.s.), ke mësuar përmendsh?

Ndërsa kur ai dilte nga shtëpia, ajo e këshillonte kështu:

“Ki frikë Allahun dhe mos fito në rrugë haram! Ne mund ta durojmë urinë në këtë botë, por nuk mund ta durojmë dënimin e xhehenemit në botën tjetër!”

(Abdulhamid Keshk, Fi rihabi't-tefsir, I, 26.)

Ja ky është ndryshimi i gruas së devotshme...

E kundërta e grave të kohës sonë, të cilat i shtyjnë burrat e tyre drejt zjarrit për pasuri dhe rehati të kësaj bote... Një pjekuri shpirtërore e pashoqe, që çdo mëngjes e përcjell burrin e saj, duke i thënë: “Mos sill haram në shtëpi!”

Për gruan e tillë, Profeti (a.s.), ka thënë:

“Nga kjo botë, më janë bërë të dashur tri gjëra: njëra prej tyre është gruaja e devotshme.” (Nesai, Ishretu'n-Nisa, 10; Ahmed bin Hanbel, III, 128, 199)

Para nesh kemi si model për t'u marrë shembull, nënat tona Hadixhe, Aishe dhe Fatimja (r.anhuma).

Shoqëria përjetësohet me nënat e devotshme.

Ndërsa me gratë e prishura shkatërrohet. Rasullullahu (a.s.), ka thënë: “Në miraxh m'u tregua se në xhehenem do të ketë më shumë gra (të prishura).”

(Buhari, Rikak, 51; Muslim, Zuhd, 93)





Gjithmonë duhet ta llogaritim veten tonë. Vallë, në cilën fazë të atyre modeleve jam në aspektin e përfaqësimit të karakterit, nderit dhe dinjitetit islam?

3. NDERI DHE DINJITETI

Cilësia morale më e bukur e gruas së devotshme është nderi dhe dinjiteti...

Allahu i Madhëruar, në emër të grave të Profetit (a.s.), e porositi të gjithë umetin e Muhamedit (a.s.):

“O gratë e të Dërguarit! Ju nuk jeni si gratë e tjera. Nëse i frikësoheni Allahut, mos flisni me përkëdheli, që të mos ju dëshirojë ai që ka zemër e pshore, por flisni drejt dhe në mënyrë të ndershme! Qëndroni në shtëpitë tuaja e mos i zbuloni stolitë tuaja, ashtu siç zbuloheshin në kohën e padijes! Falni namazin, jepni zekatin dhe binduni Allahut e të Dërguarit të Tij! O Familje e Profetit! Në të vërtetë, Allahu do që ta largojë prej jush papastërtinë dhe t’ju pastrojë plotësisht.” (Ahzab, 32-33)

Sipas transmetimit të Sa’lebit dhe të të tjerëve, kur Aishja (r.a.), e lexonte këtë ajet, qante derisa i lagej mbulesa. Ndërsa kur e pyesnin Sevden (r.a.):

“Përse nuk shkon në haxh dhe në umre ashtu si motrat e tua?”, ajo u përgjigjej:

“Haxhin dhe umren e kam bërë më parë. Allahu më ka urdhëruar të qëndroj në shtëpi.”

*Miqësia e burrit dhe gruas së devotshme,
është miqësia e xhenetit në të ardhmen.
Ëjeta e devotshme e përjetëson të përkohshmen.*





Transmetuesi thotë:

“Betohem në Allahun se nuk doli nga dera e shtëpisë derisa doli xhenazja e saj.” Allahu qoftë i kënaqur me të.

Të parët tanë, kanë treguar kujdes shumë të madh për të mbrojtur nderin dhe dinjitetin e gruas së devotshme. Për shembull, Sulltan Mehmet Fatihu, në një akt-marrëveshje vakëfi, shprehet:

“Në strehimoren që kam ndërtuar brenda kompleksit tim, të strehohen e të hanë ushqim familjet e dëshmorëve dhe të varfrit e qytetit të Stambollit. Kurse atyre që s’munden të vinë vetë për të ngrënë ose për të marrë ushqim, t’u çohen ushqimet në errësirën e mbrëmjes në enë të mbyllura dhe pa u parë nga askush...”

Këto masa delikate që janë marrë, nuk kanë qenë vetëm për të ruajtur personalitetin e gruas, por edhe nderin e saj. Ndjenjat e mbrojtjes së nderit tek të parët tanë, përfshinte edhe gratë e jomyslimanëve.

Në një ferman të nxjerrë pas çlirimit të Bosnjës, Sulltani Mehmet Fatih, shprehet:

“Bëni kujdes, që kur vajzat serbe të shkojnë tek burimi për të mbushur ujë, ushtarët e mi të mos ndodhen aty!..”

Ky ferman shpreh garantimin e nderit dhe namusit nga ana e Perandorisë Osmane. Mehmet Fatihu, me anë të këtij fermi, ka mbrojtur edhe nderin e ushtarëve të tij, por edhe nderin e vajzave të krishtera që ndodheshin nën garancinë e tij.

*“Sa dasmë e keqe
është ajo ku ftohen të pasurit
dhe nuk thirren të varfrit!”*

(Buhari, Nikah, 72; Muslim, Nikah, 107)





4. MBULESA FIZIKE DHE SHPIRTËRORE

Mbulesa... Është edhe shkak i mbrojtjes së nderit të gruas, por edhe një tablo e delikatesës dhe madhësisë së gruas myslimane... Ajo është mbrojtje e personalitetit femëror. Mbulesa... Do të thotë të mos bëhesh mjet i nxitjes së epsheve të egos dhe të jesh shprehje e vlerës që i jep të tjerëve ndjenjën e delikatesës dhe edukatës... Ajo është sekreti i ruajtjes së bukurisë vetëm për ata që e kanë hallall dhe mos shfaqja e saj të huajve...

MBULESA ËSHTË URDHRI I ALLAHUT:

“Thuaju besimtareve që të ulin shikimet e tyre (nga e ndaluara), ta ruajnë nderin e tyre (nga marrëdhëniet e jashtëligjshme) dhe të mos i shfaqin stolitë e tyre, përveç atyre që janë të dukshme.

Le t’i mbulojnë kraharorët me mbulesat e tyre (të kokës) dhe të mos ua shfaqin stolitë e tyre, përveçse bashkëshortëve të tyre ose baballarëve të tyre, ose vjehërrve të tyre, ose bijve të tyre, ose djemve të bashkëshortëve të tyre, ose vëllezërve apo djemve të vëllezërve të tyre, ose djemve të motrave a grave të tyre, ose atyre që i kanë nën zotërim (si skllave), ose shërbëtorëve që nuk kanë epsh ndaj femrave apo fëmijëve që nuk i dinë ngacmimet e femrave.

Dhe të mos i rrahin këmbët (për tokë), në mënyrë që të mos duken stolitë e tyre të fshehta.

*Nëse edukoni një mashkull,
do të keni edukuar një njeri.
Por nëse edukoni një femër, do të keni edukuar
një familje. Madje, një pjesë
të madhe të shoqërisë.*





Të gjithë ju, o besimtarë, kthehuni tek Allahu të penduar, që të arrini shpëtimin!” (Nur, 31)

Zbatimi me përpikëri i mbulesës, është urdhri i Profetit tonë (a.s.):

Dihje (r.anhu), thotë:

“Rasulullahut (a.s.), iu soll një lloj kumashi i hollë i quajtur kubtije. Njërën prej tyre ma dha mua dhe tha:

«Ndaje më dysh dhe me një pjesë qep një këmishë për veten, ndërsa tjetrën jepja gruas ta bëjë mbulesë për kokën!» Sapo u ktheva për të ikur, Profeti (a.s.), më tha:

«I thuaj gruas, që poshtë kësaj cope të hollë, të vesh diçka tjetër që nuk e tregon trupin!» (Ebu Daud, Libas, 36/4116.)

Mbulesa, nuk është vetëm një mbulim material, por në të njëjtën kohë, është edhe një mburojë nderi shpirtërore...

Me mbulimin e femrës, mbrohet personaliteti femëror. Me mbulesën e saj, gruaja reflekton tek të tjerët, ndjenjën e delikatesës dhe edukatës. Në të kundërtën, gruaja kthehet në një objekt epshi, që nxit dëshirat e egos, gjë e cila ul karakterin dhe dobëson cilësinë e të qenit nënë. Pika që duhet theksuar në këtë çështje, është:

Në aspektin e krijimit, ndërmjet egove të femrës dhe të mashkullit ka dallime. Dhe kjo ka lindur prej ndryshi-

Muhamed Ikbal: “O grua myslimane, mbulesa jote është perdja e namusit tonë! Drita në fytyrën tënde, është depozita e kandilit të besimit tonë. Pastërtia e krijimit tënd, është një mëshirë për ne nga i Vërteti, forca e fesë sonë dhe thelbi i ekzistencës së umetit tonë.”





mit të detyrave të caktuara prej Allahut për mashkullin dhe femrën dhe prej cilësive të lidhura me to. Për këtë arsye, forma e mbulesës së gruas me atë të burrit, është e ndryshme.

Në krahasim me burrin, gruaja është më tërheqëse si natyrë. Ndërkohë që trupi i mashkullit ka linja të drejta, trupi i femrës është me forma. Për këtë arsye, ajo ka nevojë për një mbulesë që do t'i mbulojë asaj linjat e trupit, duke e ruajtur nga sytë e huaj.

Kur gruaja largohet prej mbulesës dhe e zbulon veten në shoqëri, delikatesa dhe edukata e saj dobësohen. Ndërsa cilësia e të qenit nënë dhe e mbrojtjes së brezave, cenohet rëndë. Nga ky aspekt, cilësia e saj tërheqëse, në sajë të urdhrit të mbulesës, i është kushtuar vetëm burrit të saj.

Kjo, sepse midis mashkullit dhe femrës, ekziston një prirje e natyrshme dhe e pandryshueshme ndaj njëritjetrit, e cila shërben për vazhdimin e njerëzimit. Nëse nuk respektohet siç duhet urdhri hyjnor i mbulesës, kjo prirje, mund të kthehet në një shkatërrim moral të rrezikshëm, e cila mund të çojë deri aty, sa të shkelen edhe kufijtë hyjnor. Për rrjedhojë, një nga kuptimet e urdhrit hyjnor të Allahut të Madhëruar, **“Mos iu afroni zinasë!..”**, është edhe, “Mos ia hapni rrugën, mos i jepni mundësi zinasë, duke mos respektuar urdhrin e mbulesës.”

Ky tashmë është një ligj absolut. Nëse vihet re me

*Sulltan Mehmet Fatihu,
në një ferman të nxjerrë pas clirimit të Bosnjës,
thotë: “Bëni kujdes, që kur vajzat serbe të shkojnë
tek burimi për të mbushur ujë, ushtarët e mi
të mos ndodhen aty!..”*





vëmendje, Islami e ka urdhëruar mbulesën edhe për një grua që nga pamja e jashtme nuk është tërheqëse. Pra, nuk thuhet:

“Edhe nëse kjo grua i zbulon këmbët dhe krahët nuk bën ndonjë ndryshim, sepse ajo nuk është tërheqëse.” Në thelb të kësaj çështjeje, qëndron mbrojtja e dinjitetit të gruas me anë të mbulesës.

Kujdesi ndaj kritereve që na ka dhënë Profeti ynë (a.s.), në këtë çështje dhe në të gjitha çështjet e tjera, duhet të jetë i madh dhe lidhja jonë me të nuk duhet të mbetet vetëm në mendje. Ajo duhet të shprehet me vepra që bëhen me zemër.

Gruaja myslimane që vishet me këto katër cilësi që përmendëm më lartë, pra, grua që bëhet mbështetëse e burrit në punë të mira, që kërkon vetëm hallallin, që është e ndershme dhe dinjitoze dhe që me mbulesën e saj fizike dhe shpirtërore shfaq bukurinë e Islamit, është me të vërtetë një grua e devotshme.

Edukimi i vajzave tona brenda këtyre kritereve, duhet të jetë detyra e nënave dhe mësuesve.

Në çerdhen familjare që do të ndërtojë një shoqëri, një grua dhe një burrë i devotshëm, mund të formohen fëmijë që do të jenë drita e syrit. Për këtë arsye, edhe ceremonitë e martesës, edhe dasmat, duhet të jenë të bazuara në Islam...

Kushtet negative të kohës dhe mangësitë e prindërve në aspektin shpirtëror dhe moral, bëhen shkak që fëmijët ta kërkojnë arsimin dhe edukimin në adresa të gabuara.





MARTESA DHE DASMAT

Martesa, është një mirësi dhe urtësi e Allahut të Madhëruar. Në Kuranin Fisnik, në lidhje me institucionin e martesës, gjenden shumë urtësi për ata që mendojnë:

“Dhe një prej shenjave të Tij është që prej jush krijoi për ju bashkëshortet tuaja, që të qetësoheni pranë tyre, duke vënë ndërmjet jush dashuri dhe mëshirë. Me të vërtetë, në këtë ka shenja, për njerëzit që mendojnë.”

(Rum, 21)

Me të vërtetë se, nëse mendohet mirë, martesa është një urtësi shumë e madhe:

Dy persona të huaj për njëri-tjetrin, bashkohen në sajë të një programi të caktimit të Allahut. Dashuria dhe interesi i deriatëhershëm për shtëpinë e prindërve, prej asaj dite orientohet për nga çerdhja e përbashkët familjare. Siç shprehet edhe ajeti i mësipërm, këtu shfaqet urtësia e Allahut, i Cili krijon një dashuri dhe mëshirë ndërmjet gruas dhe burrit.

Martesat dhe dasmat, duhet të bëhen në bazë kënaqësisë së Allahut të Madhëruar dhe Sunetit të Profetit tonë (a.s.).

Në radhë të parë, sot po dëgjojmë për martesa që mbahen të fshehta. Martesa duhet të shpallet hapur. Është kusht që në martesë të marrin pjesë së paku dy dëshmitarë. Ndërsa organizimi i një gostie apo një dasme

*Me anë të diplomave dhe gradave
të kësaj bote, po i jepet prioritet maturimit
dhe zhvillimit të fëmijëve vetëm në planin e jashtëm
dhe, për rrjedhojë, lumturia po kërkohet
në rrugica qorre.*





për ta shpallur këtë martesë, është sunet i Profetit (a.s.). Martesa e fshehtë, shkakton shumë padrejtësi dhe grindje.

Në dasmat tona, duhet të respektojmë ligjin, moralin dhe edukatën islame. Mirëpo, për fat të keq, në ditët tona:

- Dasmat janë kthyer në pasarelë mode dhe zhveshjeje.
- Nëpër dasma nuk respektohen më parimet e intimitetit.
- Në dasma bëhet garë në luks dhe shpenzime të panevojshme.

Për fat të keq, përfshi edhe personat që në jetën e përditshme i respektojnë kufijtë e Islamit, kur bëhen dasma të tilla, njerëzit lëshojnë pe në parimet islame. Mirëpo Islami nuk duhet harruar në asnjë çast të jetë sonë.

Duhet menduar se:

Dasma është vendi dhe koha ku po ndërtohet një familje.

Për këtë arsye, ka rrezik që sjelljet dhe ndjenjat negative që do të shfaqen aty, të ndikojnë negativisht edhe në familjen e re që po ndërtohet. Mbi këtë çështje duhet menduar duke parë edhe marrëdhëniet e këqija të çifteve dhe divorcet e shumta që po ndodhin në ditët tona.

Në një dasmë, burri, gruaja dhe familjet e tyre, kanë

Muhjidi ibn Arabiu:

"Sadakaja xharije më e mirë është të bëhesh shkak i një martese. Kjo, sepse prej çdo të mire që do të veprojnë ata që do të lindin prej kësaj martese, ka një shpërblim."





më tepër nevojë për lutjet e sinqerta të nevojtarëve dhe të vetmuarve (që thirren në dasmë). Për rrjedhojë, në dasmat tona duhet të krijohet një atmosferë shpirtërore, me të cilën do të kënaqet Allahu i Madhëruar dhe Profeti i Tij (a.s.). Dhe për ta realizuar këtë, në dasmë duhet të ftohen edhe fqinjët, të afërmit e largët dhe të afërt, të varfrit dhe në mënyrë të veçantë, njerëzit e vetmuar të cilët luten vazhdimisht.

Në një hadith fisnik, Profeti (a.s.), shprehet në formë qortimi:

“Sa dasmë e keqe është ajo ku ftohen të pasurit dhe nuk thirren të varfrit!” (Buhari, Nikah, 72; Muslim, Nikah, 107)

Pra është e domosdoshme që dasmat të zhvillohen në atë mënyrë, që të tërheqin mëshirën e Allahut të Madhëruar, sepse Ai është që do të falë lumturi.

Jeta martesore duhet të ndërtohet mbi themelet e devotshmërisë. Pra, kjo jetë e re dhe këto dasma duhet të fillohen me këndimin e Kuranit, ligjërime shpirtërore dhe lutje drejtuar Allahut të Madhëruar. Gjithashtu, duhet të kërkohen edhe lutjet e njerëzve të devotshëm.

Nëse respektohen këto parime, në çerdhen e asaj familjeje do të zbresë mëshira dhe mirësia e Allahut të Madhëruar dhe frymëzimi shpirtëror i çerdhes familjare të Profetit tonë (a.s.). Insh'Allah, në atë çerdhe do të rriten dhe edukohen breza që do të jenë drita e syrit tonë.

Brezat e ardhshëm, do të lëshojnë filiza në zemrat plot butësi dhe mëshirë të vajzave të edukuara dhe të devotshme. Nëse prindërit nuk i ndihmojnë vajzat e tyre të zhvillohen dhe të aftësohen në aspektin shpirtëror, por i lënë ato në mëshirë të rrugëve, duke i çuar dëm, së bashku me të ardhmen e tyre, do të shkatërrojnë edhe të ardhmen e vet.





Për ne është shumë e rëndësishme ta këshillojmë njëri-tjetrin me këto të vërteta dhe tua vëmë veshin këtyre këshillave. Në këtë kuadër, këto cilësi të larta që vulosin fisnikërinë e gruas myslimane, janë prej këshillave më të bukura.

KËSHILLAT E NJË NËNE FISNIKE NDAJ VAJZËS SË SAJ

Umame bint-i Haris, kur po e martonte vajzën e saj Unasen me një prej mbretërve të Kindes, Haris bin Amrin, e këshilloi kështu vajzën e saj:

“Shiko bija ime! Nëse këshilla ndaj dikujt do të braktisë për shkak të edukatës, fisnikërisë dhe ndjenjave të atij njeriu, atëherë unë nuk do të kisha nevojë të të këshilloja ty. Mirëpo, këshilla, është kujtim për atë që di dhe shpjegim për atë që nuk e di. Për këtë arsye, ajo është e dobishme për të gjithë.

Bija ime! Nëse një vajzë nuk do t’ia kishte nevojën burrit për shkak të pasurisë së prindërve, atëherë ti do të ishe më e panevojshme se çdo kush tjetër. Mirëpo, kjo nuk është kështu dhe, ashtu siç janë krijuar burrat për ne, edhe ne jemi krijuar për ta.

O bija ime! Ti po ikën prej shtëpisë së prindërve, ku je rritur dhe edukuar, në shtëpinë e një burri të huaj për ty. Prandaj, bëhu si shërbyesja e atij njeriu duke iu bindur dhe duke kërkuar kënaqësinë e tij, që ai të bëhet

*“Thuaju besimtareve që të ulin shikimet e tyre
(nga e ndaluara), ta ruajnë nderin e tyre
(nga marrëdhëniet e jashtëligjshme)
dhe të mos i shfaqin stolitë e tyre!..”*

(Nur, 31)





shërbyesi yt, të të dojë dhe të bëjë gjithçka që ti të jesh e kënaqur. Për këtë arsye, tani do të të mësojë dhjetë gjëra. Mësoi përmendësh ato dhe kur të duhen, vëri në punë me qëllim që t'ia kalosh mirë me burrin tënd:

1. Çfarëdo ushqimi dhe veshjeje të të sjellë, duhet t'i pranosh me gjithë shpirt.
2. Ato që t'i urdhëron bëji, ndërsa ato që t'i ndalon mos i bëj.
3. Përpiqu të mbash pastër dhe të rregullt shtëpinë dhe veten tënde.
4. Duhet të ruhesh patjetër prej gjërave që nuk janë të pëlqyeshme kur shihen apo kur merren erë, me qëllim që të mos i pështirosesh e të të bjerë vlera para tij.
5. Ndiqe me vëmendje kohën kur dëshiron të hajë dhe të flejë. Pra, në cilat kohë të jetë mësuar t'i kryejë këto gjëra, atëherë duhet t'ia përgatitësh ushqimin dhe shtratin, sepse uria dhe pagjumësia e nervozon njeriun.
6. Pasurinë e burrit duhet ta ruash prej shpërdorimit dhe dëmtimit.
7. Duhet të kujdesesh për prestigjin e burrit dhe të respektosh marrëdhëniet me të afërmit e tij.
8. Mos e kundërshto dhe mos u rebelo ndaj tij në asnjë çështje.

Në dasmat tona duhet të krijohet një atmosferë shpirtërore, me të cilën do të kënaqet Allahu i Madhëruar dhe Profeti i Tij (a.s.).

Dhe për ta realizuar këtë, në dasmë duhet të stohen edhe sqinjët, të afërmit e largët dhe të afërt, të varfrit dhe në mënyrë të veçantë, njerëzit e vetmuar të cilët lutën vazhdimisht.





9. Sekretin e tij nuk duhet t'ia zbulosh askujt. Nëse e kundërshton urdhrin e tij, e bën të të urrejë, nëse i zbulon sekretin, të jesh e sigurt se do të jetë i pamëshirshëm.

10. Bija ime, bëj kujdes! Nëse burri yt është i hidhëruar, mos qëndro e gëzuar. Dhe, kur ai të jetë i gëzuar, mos qëndro e hidhëruar!” (Mehmed Zihni Efendi, “Meşhur Kadınlar”, I, 52-53.)

O GRUA MYSLIMANE!

Muhamed Ikbali, në një poezi të vetën, i drejtohet kështu gruas myslimane:

“O grua myslimane, mbulesa jote është perdja e namusit tonë!

Drita në fytyrën tënde, është depozita e kandilit të besimit tonë. Pastërtia e krijimit tënd, është një mëshirë për ne nga i Vërteti, forca e fesë sonë dhe thelbi i ekzistencës së umetit tonë. Ti je ajo që ia mëson për herë të parë “shehadetin” sapo fëmija ynë lë gjirin. Dashuria jote, rregullon gjendjen, mendimin, fjalën dhe punën tonë.

O grua Islame, që të janë lënë amanet mirësitë e fesë! Prushi i zjarrit të fesë së vërtetë, është ndezur prej teje.

Ky shekull është hipokrit dhe hileqar. Nga jashtë është i zbukuruar, por përbrenda kundërmon. Kusarët e këtij shekulli, u presin rrugën karvanëve në rrugën e fesë. Urtësia e këtij shekulli është e verbër, nuk e njeh Zotin.

Umame binti Haris: “O bija ime!

Ti po ikën në shtëpinë e një burri të huaj për ty. Prandaj, bëhu si shërbyesja e atij njeriu duke iu bindur dhe duke kërkuar kënaqësinë e tij, që ai të bëhet shërbyesi yt, të të dojë dhe të bëjë gjithçka që ti të jesh e kënaqur.





Vetëm ata që i kanë ikur njerëzores, mund t'i dorëzohen zinxhirëve të egos së këtij shekulli. Syrin e këtij shekulli e ka zënë lakmia dhe gjaku. Ai sheh pamëshirë. Qerpikët e tij janë bërë si kthetra, aq sa atë që shtie në dorë e lidh pas vetes.

Ai që bie në kurthin e këtij shekulli, e pandeh veten të lirë. Ai ka pirë helm prej dorës së këtij shekulli, por ende e pandeh veten të gjallë. Ti je uji i jetës së filizit të shoqërisë. Ti je roja që mbron amanetin e umetit. Zbuloji me mendjen tënde virtytet e larta të natyrës tënde! Fatimja, është një shembull për ty. Mos ia ndaj sytë dhe zemrën asaj, derisa edhe dega jote të japë një frut Husejn; trëndafilishta të sjellë stinën e vjetër.”

O Zot!..

Bëji gratë dhe fëmijët tanë dritë syri për të dyja botët!.. Jepu vajzave, grave dhe nënave tona vullnetin dhe mundësinë që ta jetojnë Islamin si Ehli Bejti, gratë e Profetit (a.s.) dhe gratë sahabe!..

Amin!..



*Umame bint-i Haris: “Bija ime, bëj kujdes!
Nëse burri yt është i hidhëruar, mos qëndro e gëzuar.
Dhe, kur ai të jetë i gëzuar, mos qëndro e hidhëruar!”*





Dërmbajtja

PARAQITJE 5



**Statusi i femrës në Hebraizëm,
Krishtërim dhe në Injorancë
Statusi i saj në Islam
GRUAJA E DEVOTSHME**

Si konsiderohet femra në Hebraizëm, Krishtërim dhe në Injorancë? Si konsiderohet në Islam? GRUAJA E DEVOTSHME.....	11
GRUAJA NË SYTË E IHTARËVE TË LIBRIT TË SHTREMBËRUAR: LODRA E SHEJTANIT	13
KONSIDERATA E GRUAS NË INJORANCËN MODERNE: OBJEKT ABUZIMI	17
GRUAJA E MIRË NË VËSHTRIMIN E ISLAMIT: KRIJESA MË E MIRË NË BOTË.....	20
TË MOS THYEN QELQURINAT!.....	33



NËNA: NJË SHKOLLË MË VETE

NËNA: NJË SHKOLLË MË VETE	41
PROFETI (A.S.), NUK E NEGLIZHOI EDUKIMIN E GRAVE SAHABE.....	44
VULLNETI I GRAVE SAHABE PËR TË FITUAR SEVAPE.....	47
CILËSITË E GRUAS SË DEVOTSHME	53
1. MBËSHTETJA NË PUNË TË MIRA	53
2. KËRKON VETËM HALLALLIN	57
3. NDERI DHE DINJITETI	59
4. MBULESA FIZIKE DHE SHPIRTËRORE.....	61
MBULESA ËSHTË URDHRI I ALLAHUT:.....	61
MARTESA DHE DASMAT.....	65
KËSHILLAT E NJË NËNE FISNIKE NDAJ VAJZËS SË SAJ	68
O GRUA MYSLIMANE!	70